

RAPORT
I VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit
Master Profesional në “Sisteme të Energjisë”
Universiteti Privat “Albanian University”

Ekspertë të vlerësimit të jashtëm:

1. Dr.Lindita Dhamo

2. Dr. Thomaq Koblara



(Qershor/2019)

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit MP "Sisteme të Energjisë"

Tabela e të dhënave të licencimit për programin e studimit:		
1	IAL Aplikues:	Universiteti Privat "Albanian University"
2	Fakulteti që e ofron	Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Urdhër të MASR Nr.674 datë 12/10/2018.
4	Titulli i programit të studimit:	Sisteme të Energjisë
5	Cikli i studimit:	I dytë
6	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik
7	Kreditet në total (ECTS):	60
8	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	me kohë të plotë
9	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
10	Programi ofrohet nga institucioni	Po
11	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Jo
12	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
13	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	7
15	Aktivizimi i programit të studimit	2018-2019
16	Studente	31

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Master Profesional në “Sisteme të Energjisë”

Programi i studimit Master Profesional (MP) në “Sisteme të Energjisë” mbështetet nga Departamenti i Inxhinierive, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike në Albanian University (AU). Albanian University është një Institucion i Arsimit të Lartë jopublik, i licencuar në Prill të vitit 2004, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë. Departamenti i Inxhinierive ka filluar aktivitetin e tij në vitin 2010 me emërtimin Departamenti i Elektronikës, si pjesë e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierive. Në vitin 2014, Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierive u bashkua me Fakultetin e Ekonomisë, duke u riorganizuar në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara me 3 departamente: Departamenti i Arkitekturës, Departamenti i Inxhinierive, Departamenti i Shkencave Ekonomike. Departamenti ndryshon emërtimin nga Departamenti i Elektronikës në Departamenti i Inxhinierive në vitin 2016 dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara riorganizohet me emërtimin Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike.

Programi i studimit MP në Sisteme të Energjisë, është hapur nga ky Institucion në vitin akademik 2018-2019 me Urdhër të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 674, datë 12/10/2018. Për herë të parë në vitin akademik 2018-2019 janë regjistruar 31 studentë. Në fund të vitit akademik aktual del brezi i parë i të diplomuarve nga ky program studimi. Studentët do të diplomohen pasi të kenë mbrojtur një temë diplome.

Programi i studimit MP në Sisteme të Energjisë zhvillohet në ambientet e ndërtesës së Albanian University në Krugën e Kavajës, Tiranë, në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike dhe mbështetet nga Departamenti i Inxhinierive.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ: Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën: Dr. Lindita Dhamo dhe Dr. Thomaq Koblara, si ekspertë të jashtëm vlerësimi për këtë program studimi. Gjatë gjithë procedurës ekspertët e vlerësimi të jashtëm janë asistuar nga Kordinatori Teknik i ASCAL, Z. Erjon Xhako. Draft-Raporti i Vlerësimi të jashtëm është dërguar në Institucion më datë 13.06.2019 me anë të sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr.9/15 prot. Datë 13.06.2019. Institucioni ka sjellë me anë të shkresës nr. 355 prot. Datë 17.06.2019, komentet mbi draft raportin.

GVJ, pasi lexoi me vëmendje komentet e institucionit mbi Draft-Raportin e vlerësimi për programin e studimit në fjalë, sqaron si më poshtë:

-Për komentin: *Programet aktualisht aktive pranë Departamentit të Inxhinierive janë: 5 programe Bachelor, 2 programe Master i Shkencave dhe 1 program Master Profesional [Evidencë 6.3.b]. Programi Master Profesional në Sisteme të Energjisë është licensuar me Urdhër të MASR Nr. 674 datë 12/10/2018, për këtë arsye nuk është i përfshirë në këtë evidencë.* GVJ në hartimin e raportit është mbështetur në dokumentacionin e paraqitur në dosjen e akreditimit, por shifra 4 për PS Master i shkencave është një lapsus. **Raporti në këtë pikë ndryshon.**

-Për komentin: *MP në Sisteme të Energjisë është licensuar me Urdhër të MASR Nr. 674 date 12/10/2018. Rregullorja e Departamentit të Inxhinierive është miratuar me vendim të Senatit Akademik. Nr. 8, date 28.02.2018. Rregullorja e departamentit, ashtu si edhe rregulloret e programeve të studimit, rishikohet cdo fillim viti (konkretisht ndryshimet do të reflektohen gjatë rishikimeve për vitin e ri akademik 2019 – 2020).* GVJ ka përmendur fakte të gjetura në dokumentacion dhe mendon që institucioni ka të drejtë të bëjë pasqyrimet e ndryshimeve në dokumentacione sipas rregullores së brendshme të tij. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

-Për komentin: *Në Tabelën 7, “Zyra për sekretarinë mësimore/kryesekretar i fakultetit⁴”, Zyra për sekretarinë mësimore me sipërfaqe 35.14 m², ndodhet në Godinën e Rr. së Kavajës, ndërsa Zyra e kryesekretarit ndodhet*

në Godinën e Blv. Zogu I. Për këtë arsye sipërfaqja totale në këtë godinë është 191.99 m². Staf i që punon në këtë godinë është 64. Raporti $170.43/64 = 2.66 \text{ m}^2/\text{staf}$. GVJ mbështetur në RVB, faqe 18, ka bërë llogaritjet më sipër, ku stafi është deklaruar 78, ndërsa zyra për sekretarinë mësimore nuk jepet si e dhënë më vete. Mendojmë se ndryshimi nuk mund të bëhet pa u bërë reflektimet në dokumentacionin përkatës. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

-Për komentin: *Programi Master Profesional në Sisteme të Energjisë është një master i ri në përmbajtje në rang kombëtar, për këtë arsye literatura në gjuhën shqipe është e kufizuar. Pavarësisht kësaj, ashtu siç shpreheni edhe ju në RVJ, fq. 22, "Gjatë vizitës në ambientet e universitetit u shqyrtuan dhe materialet mësimore si dhe bibliografia nga ku ato janë tërhequr. Për të gjitha lëndët mësimore ekziston materiali në gjuhën shqipe si dhe bibliografi plotësuese në gjuhë të huaj. Studentët e marrin informacionin në bibliotekë. Të gjitha materialet didaktike për masterin profesional në energjitikë (Sisteme të Energjisë) ishin të dokumentuara në CD, të cilën studentët mund të merrnin në përdorim."* Staf akademik i angazhuar në këtë program studimi ka hartuar materiale mësimore të përshtatshme me programet e lëndëve për realizimin korrekt të mësimdhënies dhe ka vënë në dispozicion të studentëve shumëllojshmëri materiale mësimore mbështetëse, si në gjuhën shqipe, edhe në anglisht. Në çdo rast Departamenti angazhohet në një përmirësim të vazhdueshëm në përputhje me propozimet më të fundit bashkëkohore në literaturë. GVJ ka shprehur mendimin e tij në përputhje me informacionin e marrë në DA dhe nga vizita në institucion. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

-Për komentin: *Programi i studimit përfshin 11 veprimtari, 9 lëndë gjatë dy semestrave (ndër të cilat 2 lëndë me zgjedhje), 1 praktikë profesionale dhe teza e diplomës.* GVJ ka shprehur mendimin e tij në përputhje me informacionin e marrë në DA dhe nga vizita në institucion, Kjo del dhe nga programi mësimor i Masterit-it Profesional në Sistemet e Energjisë. **Raporti në këtë pikë ndryshon.**

-Për komentin: *RVB është shkruar në përfundim të semestrit të parë të vitit akademik. Gjatë semestrit të dytë, gjithashtu, studentët kanë shprehur mendimet e tyre përmes pyetësorit për lëndët dhe stafin e semestrit të dytë.* GVJ- Vizita në institucion u zhvillua në semestrin e II-të dhe GVJ nuk kishte raporte në lidhje me pyetësorin, zhvillimin e lëndëve mësimore dhe stafin akademik të semestrit të dytë. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

-Për komentin: *Programi i studimit është hartuar bazuar në programe të ngjashme të Europës Perëndimore, SHBA, Kanada dhe Australi [Evidencë 1.7]. Hartimi i syllabuseve është bazuar gjithashtu në eksperiencat e këtyre vendeve.* GVJ është shprehur se programi mësimor është në përputhje me strategjinë e zhvillimit të sistemeve të energjisë. Kjo strategji bazohet në standardet e vendosura në nivel internacional. Programi është i bazuar në eksperiencat e vendeve të Europës perëndimore dhe më tej. GVJ ka konstatuar se pedagogët përgjegjës për ndërtimin e programit të studimit janë konsultuar dhe me programe mësimore të ngjashme. Çdo vend dhe çdo fakultet që zhvillon programe studimi bazohet dhe në specifika të veçanta në funksion të interesave kombëtare, të cilat programi respektiv nuk mund ti pasqyrojë. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

-Për komentin: *Programi i studimit Master Profesional në Sisteme të Energjisë ofron njohuri profesionale në përputhje me nivelin e programit të studimit, si dhe objektivat specifike të tij, bazuar edhe në kurrikula të ngjashme ndërkombëtare.* GVJ është shprehur se programi mësimor është në përputhje me strategjinë e zhvillimit të sistemeve të energjisë dhe me praktika të ngjashme ndërkombëtare. Programi nuk ofron njohuri të thelluara në fushën e sistemeve të energjisë elektrike si dhe në automatizimin e proceseve energjitike. Prodhimi, kontrolli dhe menaxhimi i energjisë elektrike nuk janë pjesë e orientimit të programit pasi dhe kurrikulat e sistemeve të energjisë bazohen më shumë në fushën e sistemeve energjitike termike dhe energjisë së rinovueshme por dhe këtu të energjisë termike. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

-Për komentin: *Bazuar në nenin 11, fq. 10 të rregullores së programit të studimit [Evidencë 1.1]:*

a. Kohëzgjatja normale e studimeve në programin e studimit "Master Profesional në Sisteme të Energjisë" është 1 vit akademik (dy semestra).

b. Afati maksimal i përfundimit të studimeve të plota është 2 vite akademike (dyfishi i afatit të rregullt) pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studenti i ka pezulluar studimet.

Në rregulloren e brendëshme të Universitetit është përcatuar kohëzgjatja e plotë e studimeve akademike (sa dyfishi i afatit të rregullt) por GVJ nuk mund ta verifikojë nëse është zbatuar ose jo kjo pikë për këtë program mësimor pasi është viti i parë i hapjes së tij dhe nuk ka evidence. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

-Për komentin: *Bazuar në Udhëzimin Nr. 15, datë 04.04.2018, "Për organizimin e studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë", shtojca 1, pika 5, ndarja e ECTS/orë është sipas tabelës më poshtë, pa detyrime të veçanta bazuar me nivelin e programit të studimit:*

Lloji i veprimtarisë	Numri i krediteve	Orë në auditor	Orë studimi individual	Gjithsej orë
Leksione	1 Kredit	6 - 12	19 - 13	25
Seminare	1 Kredit	6 - 8	19 - 17	25
Ushtrime	1 Kredit	12 - 18	13 - 7	25
Laboratore	1 Kredit	18 - 25	7 - 0	25
Projekt kursi/ Detyra				
Praktikë/e kspedita				

GVJ e ka verifikuar dhe plotësohet ky kriter. **Raporti në këtë pikë ndryshon.**

-Për komentin: *Bazuar në Udhëzimin Nr. 15, datë 04.04.2018, si më sipër, në këto lëndë krahas llojit të veprimtarisë "seminare" është konsideruar edhe lloji "ushtrime". Të gjitha lëndët, përveç lëndës "Teknologjitë moderne të energjisë së rinovueshme", kanë në shpërndarjen e tyre si llojin e veprimtarisë "seminare", ashtu edhe atë "ushtrime". GVJ ka konstatuar se përveç seminareve janë dhe ushtrimet. Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.*

-Për komentin: *Mbështetur në Ligjin Nr.80/2015, kreu V, Organizimi Akademik dhe Administrativ i IAL, neni 42 dhe neni 45, përdoret termi Drejtues i Njesisë Kryesore për dekanin dhe Drejtues i Njesisë Bazë për përgjegjësin e Departamentin, konkretisht:*

"Neni 42

Drejtuesi i njesisë kryesore

- 1. Drejtuesi i njesisë kryesore është dekani i fakultetit, drejtori i institutit kërkimor- shkencor, kur instituti plotëson standardet si njësi kryesore, si dhe drejtori i kolegjit profesional të lartë, në rastet kur ky i fundit krijohet pranë institucioneve të arsimit të lartë të llojit universitet ose kolegji universitar.*
- 2. Drejtuesi është autoriteti më i lartë akademik i njesisë kryesore dhe përfaqësuesi i saj....."*

"Neni 45

Drejtuesi i njesisë bazë

- 1. Drejtuesi i njesisë bazë është drejtuesi i departamentit ose i qendrës kërkimore-shkencore.*

Ai është autoriteti drejtues akademik i asaj njësie dhe e përfaqëson atë...."

Bazuar në parashikimet ligjore të sipërpërmendura, është hartuar Statuti i AU (miratuar edhe me urdhër të MASR nr... datë 21.12.2016.), tek i cili përdoren termat Drejtues i Njesisë Kryesore për dekanin dhe Drejtues i Njesisë Bazë për përgjegjësin e Departamentin, konkretisht:

"Neni 29

Dekani

1. Në AU në zbatim të nenit 42 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në R.Sh", drejtuesi i njësisë kryesore është Dekani i Fakultetit...."

"Neni 30

Përgjegjësi i Departamentit

1. Përgjegjësi i Departamentit është drejtuesi i njësisë bazë...."

Në bazë dhe për zbatim të Ligjit dhe Statutit janë miratuar edhe Rregullorja e përgjithshme dhe ajo e Fakultetit, tek të cilat janë përdorur të njëjtat terma. GVJ e ka parë të nevojshme ta bëjë këtë sugjerim mbështetur në terminologjinë e përdorur nga ligji Nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në R.Sh", pasi termat e rinj duhet të përdoren drejtpërdrejt në rregullore dhe jo të bëhet shpjegimi i termave të vjetër me termat e rinj. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

-Për komentin: Dëshirojmë t'ju sjellim në vëmendje që ky kriter nuk është cënuar pasi referuar ligjit 80/15 dhe akteve nënligjore, raporti PAE/PAK nuk është tashmë një detyrim ligjor. GVJ i është referuar Standardit III.1 Kriteri 2 për vlerësimin e ngarkesës së programit të studimit. **Raporti në këtë pikë ndryshon.**

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: *Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.*

Programi i studimit MP në Sisteme të Energjisë synon krijimin e një profili të veçantë të studentit të diplomuar në ciklin e dytë, i cili të jetë i aftë që nëpërmjet procesit të përfitimit të njohurive dhe vlerësimit, të zhvillojë një sërë shprehish dhe kompetencash, si:

- të pajisë studentët me njohuritë teknike bashkëkohore dhe aftësitë e nevojshme për menaxhimin më të mirë të energjisë,
- projektimin e sistemeve dhe proceseve me eficiencë energjitike,
- përdorimin e burimeve të energjisë së rinovueshme
- reduktimin dhe kontrollin e ndotjes me kosto efektive.

Ky program studimit është projektuar për të njohur inxhinierët me aspektin praktik të çështjeve të kursimit të energjisë dhe pasojat mjedisore të përdorimit joracional të burimeve të energjisë në sektorët industrialë dhe komercialë. Syhohet që njohuritë dhe aftësitë e fituara përmes këtij programi mund të aplikohen drejtëpërdrejtë për të ndihmuar në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Ofrohet në kuadër të rritjes së shqetësimit për ruajtjen e energjisë dhe luftën kundër degradimit mjedisor në rritje. Synon të përgatisë studentë që japin vetë zgjidhje të çështjeve praktike të projekteve të ndryshme dhe të zhvillojë aftësitë e nevojshme në veprimtarinë e subjekteve të ndryshme ku ka sisteme energjie. Ky program studimi njëvjeçar u krijon mundësinë studentëve të integrohen në tregun e punës dhe gjithashtu formon bazat e nevojshme për të thelluar njohuritë e për të përfutuar kompetenca më specifike gjatë ushtrimit të profesionit.

Mundësitë e punësimit për të diplomuarit në këtë program studimi janë në kompanitë, në ndërmarrje, laboratorë ku ka sisteme energjie elektrike ose joelektrike të industrisë, ente tregtare të ndryshme që menaxhojnë, prodhojnë ose transmetojnë energjinë, etj; Procesi mësimor dhe kërkimi shkencor në Albanian University synon rritjen e cilësisë së mësimdhënies në mënyrë që t'u japë studentëve aftësi metodologjike për kërkim si dhe përpiqet të sigurojë integrimin e mësimin me punën kërkimore. Albanian University bën përpjekje në plotësimin e disiplinave mësimore me njohuri shkencore dhe praktike të avancuara, kualifikimin e personelit akademik, si dhe krijon ambjente laboratorike për zhvillimin dhe punën në institucion, etj.

Albanian University me anë të marrëveshjeve me kompani të ndryshme mundëson realizimin e praktikave profesionale për studentët e këtij programi studimi si dhe kryen veprimtari të tjera në përputhje me statutin e Albanian University, sipas objektivave specifike të institucionit në këtë drejtim. Në kuadër të zhvillimit të kurrikulave, për programet që mbështet Departamenti i Inxhinierive, bëhen përpjekje për një përditësim të vazhdueshëm të njohurive të marra në këto programe studimi.

Sipas Planit Strategjik të zhvillimit të tij, Departamenti i Inxhinierive parashikon si strategji zhvillimi për vitin akademik 2018-2019, [Evidencë 1.2], si më poshtë:

1. Hapja e programeve të reja studimi në përputhje me nevojat e tregut
 - Master Profesional në “Inxhinieria e Inteligjencës së Biznesit”,

- “Doktoratë” në “Standardizimi: Integrimi European, transferimi i teknologjisë dhe inovacioni”.
2. Kualifikimi i mëtejshëm i të diplomuarve: kurse mbi standardet ndërkombëtare dhe europiane mbi sisteme të ndryshme menaxhimi.
 3. Mobiliteti i stafit akademik dhe administrativ.
 4. Ndërkombëtarizimi i programeve të studimit
 5. Zgjerimi i marrëveshjeve me biznese vendase në kuadër të praktikave mësimore, me këndvështrim të veçantë në kuadër të Masterit Profesional në “Sisteme të Energjisë”.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>Programi i studimit MP në Sisteme të Energjisë është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, dhe në përputhje me qëllimet dhe misionin e Albanian University.</p> <p>Programi i studimit MP në Sisteme të Energjisë ka të përcaktuar qartë objektivat për formimin e studentëve në këtë program, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit. Programi i studimit MP në Sistemet të Energjisë është hartuar në përputhje të plotë me nevojat e tregut të punës.</p> <p>Programi i studimit MP në Sistemet të Energjisë është hartuar në përputhje të plotë me zhvillimin ekonomik, duke patur parasysh që në Shqipëri ka ndërmarrje të vogla, të mesme e të mëdha, të cilat kanë nevojë për një student me diplomë MP në Sistemet të Energjisë.</p> <p>Programi i studimit MP në Sisteme të Energjisë është hartuar në përputhje dhe pasqyrojnë vullnetin e AU për ruajtjen e vlerave kulturore të vendit.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Programi i studimit MP në Sisteme të Energjisë është hartuar në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit dhe të njësisë kryesore.</p>
Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Programi i studimit MP në Sisteme të Energjisë i aktivizuar në AU ka përmbajtje në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Emërtimi i Programit të studimit MP në Sistemet e Energjisë në AU është në përputhje me nivelin 7 të kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>
Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>AU ka hartuar një plan strategjik në nivel IAL dhe në nivel Departamenti për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimit për periudhën 2017-2022 dhe 2018-2022 përkatësisht.[Evidencë 1.8]</p> <p>AU ka ngritur strukturën e NJSBC, e cila duke funksionuar deri në nivel njësie bazë, synon arritjen e rezultateve në rritje në mësimdhënie dhe mësimnxënie [Evidencë 1.8].</p>
Konkluzionet e vlerësimit:	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Programi i studimit është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, dhe në përputhje me qëllimet e misionin e Albanian University, janë në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe synojnë ruajtjen e vlerave kulturore e interesave 	

kombëtare.

2. Programi i studimit MP në Sisteme të Energjisë është hartuar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
3. Institucioni ka kryer studim të tregut të punës duke dhënë informacion për kërkesat e punëdhënësve në disa kompani të njohura dhe ka analizuar rezultatet në funksion të kërkesave të tregut të punës.

2. Struktura akademike e Fakultetit (Departamentit përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Mbështetur në RVB dhe organigramën e Albanian University, material në dosjen e akreditimit DA, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike është njësi kryesore e Albanian University që organizon e drejton mësimdhënien dhe kërkimin shkencor dhe ka 3 Departamente: Departamentin e Arkitekturës, Departamentin e Inxhinierive dhe Departamentin e Shkencave Ekonomike.

Fakulteti ofron programe të ndryshme studimi në 3 cikle studimi, që mbështeten nga 3 departamente :

- Departamenti i Arkitekturës ofron: 1 program studimi Bachelor, 1 program studimi Master i Shkencave, 1 program studimi Doktoraturë
- Departamenti i Inxhinierive aktualisht ofron: 5 programe studimi Bachelor, 2 programe studimi Master i Shkencave, 1 Master Profesional.
- Departamenti i Shkencave Ekonomike ofron 2 programe studimi Bachelor, 2 programe studimi Master i Shkencave, 2 programe studimi Master Profesional dhe 1 program studimi Doktoraturë.

Nëse krahasojmë dokumentacionin në Dosjen e Akreditimit me informacionin e marrë në faqen e AU, ka një mospërputhje me numrin e programeve të studimit që zhvillon Departamenti i Inxhinierive. Konkretisht, në rregulloren e këtij departamenti, figurojnë 5 PS Bachelor dhe 3 PS Master i shkencave, ndërsa programi i studimit MP në Sisteme të Energjisë nuk figuron. Ndërkohë në faqen zyrtare: <https://albanianuniversity.edu.al/en/faculty-of-applied-sciences-and-economics/>, rezultojnë e dhëna 5/2/1. Sugjerojmë që ndryshimet të reflektohen në dokumentet përkatëse.

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike përbëhet nga autoritete drejtuese akademike, organe drejtuese administrative, njësitë bazë, organe kolegjiale dhe nga administrata. Autoritetet drejtuese akademike janë Drejtuesi i Njësisë Kryesore dhe Drejtuesit e Njësisë Bazë ndërsa organ kolegjial është Dekanati. Asambleja e Personelit Akademik është organ drejtues akademik. Aparati administrativ i Fakultetit përbëhet nga Sekretaria mësimore dhe nga personeli ndihmës (asistentët e departamenteve, laborantët, asistentet e praktikave mesimore). Struktura organizative, përbërja, funksionimi dhe të tjera çështje që lidhen me të, përcaktohen në rregulloren e fakultetit. *Emërtimet e organeve dhe autoriteteve drejtuese të fakultetit nuk përkrijnë në çdo rast me përcaktimet e bëra në Ligjin Nr.80/2015 datë 22.07.2015. Mbështetur në kreun V të këtij ligji, Organizimi Akademik dhe Administrativ i IAL, përdoret termi Përgjegjës i Njësisë Kryesore për dekanin dhe Përgjegjës i Njësisë Bazë për përgjegjësin e Departamentit.*

Në AU, në zbatim të nenit 43 të Ligjit Nr. 80/2015, Dekanati është organ kolegjial që drejtohet nga Dekani dhe përbëhet nga:

- a. Dekani;
- b. Zëvendësddekani;
- c. Administratori i njësisë kryesore;
- d. Drejtuesit e njësive bazë.

Dekanati harton planin strategjik të zhvillimit të njësisë kryesore, mbështetur në propozimet e njësive bazë të tij, si dhe ato të Administratorit të njësisë kryesore. Dekanati koordinon veprimtarinë e njësive bazë.

Drejtuesi i Njësisë Kryesore është autoriteti akademik më i lartë drejtues dhe përfaqësues i Fakultetit, në zbatim të Statutit të AU (neni 29). Në AU, Dekani propozohet nga Rektori, dhe zgjidhet nga Senati Akademik mbi

bazë të një procesi konkurrimi, mbi bazën e kandidaturave alternative. Drejtuesi i Njesisë Kryesore duhet të gëzojë titullin shkencor "Profesor", ose "Prof. Assoc.", ai/ajo zgjidhet për një mandat 4 (katër) vjeçar, me të drejtë riemërimi vetëm një herë.

Drejtuesi i Njesisë Kryesore në ushtrim të kompetencave të tij, shprehet me vendime dhe/ose udhëzime.

Zëvendësdekani emërohet dhe shkarkohet nga Rektori, me propozim të Dekanit dhe me pëlqimin e Rektorit, për një periudhë katërvjeçare, me të drejtë riemërimi. Ai duhet të ketë së paku gradën shkencore "Doktor i Shkencave". Numri i zëvendësdekanëve të një Fakulteti përcaktohet nga Bordi i Administrimit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Struktura akademike e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara është si në skemën më poshtë, funksioni i çdo hallke u shpjegua më sipër. (Tabela 20).

Personeli akademik për çdo njësi bazë: PAE, PAK, PA, titujt/gradat, (Tabela 1).

Bazuar në RVB dhe dokumentacionin e DA, të dhënat për personelin akademik për çdo njësi bazë të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike për vitin akademik 2018 – 2019 jepen në tabelën 1. Në këtë tabelë jepet informacion për numrin e personelit akademik dhe gradat e titujt e tij për njësinë kryesore të ndarë sipas njësive bazë.

Duke u bazuar në të dhënat e kësaj table, personeli PAE i Departamentit të Inxhinierive nuk ka kategorinë Profesor. Raporti i PAE me grada/PAE pa grada është 8/11 ose 42.1% e PAE janë me gradën Doktor. Pjesa më e kualifikuar e personelit akademik është pjesa PAK, ku nga 16 gjithsej, 14 janë me grada e tituj (8 kategoria Profesor dhe 6 Doktor), dhe 2 pa grada. Gjithashtu raporti PAE/PAK është 19/16 ose 54.3% e Personelit Akademik të këtij Departamenti është PAE, dhe nga këta, vetëm 42.1% e tyre kanë gradën Doktor.

Lista e Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK) në Departamentin e Inxhinierive, për vitin akademik 2018-2019, bazuar në RVB dhe dokumentacionin në DA është si në (Tabelën 2).

Nga analiza e të dhënave të tabelave, personeli akademik PAE në Departamentin e Inxhinierive përbën 54.3% të numrit total të personelit akademik të departamentit, dhe 42.1% e tyre ka gradën Doktor (asnjë PAE i kategorisë profesor). Në lidhje me programin e studimit që po shqyrtojmë, këto tregues janë të përmirësuar.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore "Doktor".</p>	<p>Institucioni ka bërë përpjekjet e nevojshme në lidhje me organizimin e tij me qëllim përmbushjen e misionit të sanksionuar në statut.</p> <p>Institucioni ka 3 Fakultete :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fakulteti i Shkencave Mjekësore, • Fakulteti i Shkencave Shoqërore, • Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike. <p>Fakultetet organizohen në njësi bazë. Njësitë bazë janë të organizuara si departamente. Fakulteti i Shkencave Mjekësore ka 3 departamente, Fakulteti i Shkencave Shoqërore ka 4 departamente, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike ka 3 departamente. Objektivat dhe misioni i njësive bazë përcaktohet në rregulloren e departamentit përkatës .</p> <p>Fakultetet kanë nga 3 ose 4 departamente. Cdo department ka fushë studimi, objektiva e mision të mirëpërcaktuar në rregulloren përkatëse.</p> <p>Departamenti i Inxhinierive ka 19 pedagogë efektivë, nga të cilët 8 mbajnë gradën shkencore Dr. 3 pedagogë janë në proces doktorature dhe 8 me MSc.</p>
Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.	

<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Njësitë bazë dhe kryesore zhvillojnë aktivitetin e tyre në funksion të realizimit të programeve të studimit që ofrojnë në përputhje me objektivat dhe strategjinë e institucionit.</p> <p>Departamentet në përputhje me rregulloren e Fakultetit, në fillim të çdo viti akademik, bazuar në nevojat për personel akademik, i paraqet Dekanit të Fakultetit kërkesat për plotësimin e vendeve vakante .Vlerësimi i kandidatëve bëhet përmes Komisionit të Vlerësimit, pjesë e të cilit janë përfaqësues të njësisë bazë dhe kryesore.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Albanian University ka 3 fakultete, nga të cilët: 2 prej tyre kanë nga 3 departamente dhe 1 prej tyre ka 4 departamente. Misionin, objektivat dhe fushat e studimit të tyre janë shprehur në statutin e AU dhe në rregulloret përkatëse të fakulteteve e departamenteve. 2. Personeli akademik i Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike ka në përbërje Personel Akademik Efektiv dhe Personel Akademik me Kontratë. Numri i personelit akademik për fakultetet e departamentet në tërësi përmbush kriteret e standardet. 	

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Personeli akademik i Programit të studimit Master Profesional në Sisteme të Energjisë përbëhet nga 3 Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe 1 Personel Akademik me Kontratë (PAK) si dhe Personel Administrativ (PA). Ky personel akademik kryen aktivitetin e tij mësimdhënës për këtë program studimi gjatë 1 viti akademik në lëndë të karakterit teorik e praktik me 60 ETCS gjithsej. Raporti i PAE/PAK për vitin akademik 2018 – 2019 është 19/16 (e dhënë për departamentin) dhe 3/1 (e dhënë për programin e studimit). Institucioni ka bërë përpjekje që në këtë program studimi 75% e stafit akademik të angazhuar të jetë nga PAE. Cilësia e personelit PAE ka një përmirësim për programin e studimit MP në Sisteme të Energjisë pasi nga personeli PAE, 2/3 ose rreth 67% janë me gradën Doktor, dhe 1 PAK me titull Profesor. Cilësia e personelit PAE për Departamentin e Inxhinierive është 42.1% e PAE janë me tituj e grada (8/19). Pjesa tjetër e PAE është Msc. ose doktorantë në proces. Personeli PAK është pjesa më e kualifikuar e stafit, 100% me tituj e grada shkencore (për programin e studimit) dhe 14/16 ose 87.5% e PAK janë me tituj e grada (e dhënë për departamentin).

Raporti i Personelit akademik/Personelit ndihmës-akademik me karakter mësimor/Personeli ndihmës-akademik me karakter administrativ/student, për vitin akademik 2018 – 2019 është 4/2/7/31, e dhënë për programin e studimit. Kjo shifër është sipas të dhënave në RVB, por duhet të detajojmë se ky personel akademik e ndihmës akademik me karakter mësimor apo administrativ nuk është personel i dedikuar për këtë program studimi. Shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik është bërë si më poshtë: Programi i studimit ka 6 lëndë me karakter teorik dhe praktika e diploma. Këto lëndë zhvillohen nga personel akademik gjithsej 4, në raport 3PAE/1PAK. Pra 75% e programit të studimit mbulohet nga personel PAE. Nëse analizojmë ngarkesën mësimore në këtë program studimi, vihet re se 233 orë mësimore nga 311 gjithsej të lëndëve ke karakter teorik zhvillohen nga PAE. Pra , 233/311 ose 74.9% e ngarkesës mësimore në auditor kryhet nga personel akademik efektiv. Lektorët në këtë program studimi janë me gradën Doktor ose Prefesor.Asoc. Lektorët janë 67% personel PAE dhe 33% personel PAK. Mbështetur në nevojat për personel akademik, çdo fillim viti akademik Departamenti i paraqet Dekanit të Fakultetit kërkesat për plotësimin e vendeve vakante të specifikuar edhe me fushat e mësimdhënies. Dekani i Fakultetit ia përcjell këto kërkesa Rektoratit, i cili përcakton kriteret e pranimit dhe procedurat e konkurimit. Kandidati i përzgjedhur i nënshtrohet një periudhe prove deri në 3 muaj në

mbarim të së cilës përcaktohet nëse marrëdhënia e punës do të vazhdojë apo do të ndërpritet. Marrëdhënia e punës mes të punësuarit dhe universitetit rregullohet nga kontrata e punës, mbështetur në Kodin e Punës, dhe në respektim të Legjislacionit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, për programin e studimit MP në Sisteme të Energjisë, sipas të dhënave nga RVB dhe dokumentacioni në DA. (Tabela 4)
- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre për programin e studimit MP në Sisteme të Energjisë, sipas të dhënave nga RVB dhe dokumentacioni në DA. (Tabela 5).

Personeli ndihmës-akademik me karakter mësimor është në shërbim të gjithë programeve të studimit që mban Departamenti i Inxhinierive, ndërsa personeli ndihmës-akademik me karakter administrative është në shërbim për të gjithë Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike.

- Të dhëna sipas moshës për programin e studimit MP në Sisteme të Energjisë, sipas të dhënave nga RVB dhe dokumentacioni në DA. (Tabela 6/1 dhe 6/2)

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat .

Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë dhe në Kodin e Punës:

- kontratat e stafit akademik me kohë të plotë për të gjitha kategoritë profesor/lektor/asistent-lektor janë me afat të pacaktuar.
- kontratat e stafit akademik me kohë të pjesëshme për kategoritë profesor dhe lektor janë me afat të pacaktuar ndërsa për kategorinë asistent-lektor janë me afat të caktuar.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Personeli akademik dhe ai ndihmës akademik me karakter mësimor dhe me karakter administrativ angazhohen nga ana e institucionit për plotësimin e objektivave të programit të studimit, pasi kanë formimin dhe kualifikimin e nevojshëm për këtë.</p> <p>Institucioni e angazhon personelin akademik dhe ndihmës akademik për të realizuar objektivat e vendosur nga institucioni në kuadër të zhvillimit të programeve të studimeve në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Institucioni angazhon personelin akademik në grupe ekspertësh për rishikimin e kurrikulave dhe për hartimin e kurrikulave të reja. Rishikimin e syllabuseve të lëndëve e bëjnë çdo fillim viti akademik, e diskutojnë në mbledhjet e departamentit, japin sugjerimet e tyre për zhvillimin e mëtejshëm të tyre. Në këto grupe ekspertësh, departamenti ka filluar të përfshijë edhe përfaqësues të biznesit. [Evidenca 3.5]</p> <p>Institucioni ndjek procedura konform përcaktimeve ligjore në rekrutimin e personelit të ri akademik dhe në përcaktimin e ngarkesës mësimore të tyre. [Evidencë 3.1 dhe 3.6]</p>
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.	

<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Nga vizita e kryer në zyrën e burimeve njerëzore të Universitetit dhe nga kontaktet me stafin akademik të brendshëm dhe Drejtuesin e njësisë bazë të Inxhinierive konstatuam se institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente duke bërë njoftim për vende bosh në faqen e fakultetit, pasi Departamentet sjellin kërkesat e tyre dhe kërkesat specifike për kandidatët . Më tej ngrihet një komision vlerësimi nga Drejtuesi i njësisë Kryesore të Fakultetit dhe Drejtuesi i njësisë bazë për të vlerësuar kandidaturat e paraqitura.</p> <p>Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë, që mbështet këtë program studimi, për vitin akademik 2018-2019, përbën 75% të personelit akademik të angazhuar (3/4). Pjesa tjetër është personel PAK dhe është pjesa më e kualifikuar e personelit për këtë program studimi.</p> <p>Institucioni ndjek një procedurë ligjore korrekte dhe transparente të vlerësimit të personelit në fazën e rekrutimit të tij. Institucioni mban një bazë të dhënash të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë.</p>
---	---

Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.

<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve përëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Përgjegjës për programin e studimit Master Profesional në “Sisteme të Energjisë” është përgjegjësi i Departamentit Dr. G.R dhe mban gradën shkencore “Doktor” (“PhD”) të mbrojtur në perëndim. Koordinator i grup-lëndëve të fushës së Inxhinierisë Mekanike është Dr. K.K, dhe i grup-lëndëve të fushës së Inxhinierisë Elektrike, Dr. F.B.</p> <p>Titullarët e lëndëve/moduleve në programin e studimit Master Profesional në “Sisteme të Energjisë” janë të gjithë Prof. Asoc. Ose Dr. Lektorët për të gjithë lëndët/modulet kanë së paku gradën shkencore Dr.</p> <p>Në statutin e Institucionit përcaktohet forma e emërimit dhe kohëzgjatja e saj për rektorin, zv/rektorët, dekanin dhe përgjegjësin e departamentit. Ata janë pjesë e stafit akademik me kohë të plotë të Institucionit. Praktikat mësimore zhvillohen, brenda afatit të caktuar në kalendarin akademik, në institucionet me të cilat <i>Albanian University</i> ka marrëveshje bashkëpunimi dhe nën drejtimin e një pedagogu të caktuar nga Departamenti. Departamenti kujdeset që çdo pedagog të ketë nën mbikqyrje jo më shumë se 20 studentë. Gjithashtu, në kuadër të marrëveshjeve për praktikat mësimore, parashikohet përcaktimi nga ana e institucionit pritës i një udhëheqësi të praktikës, i cili kontrollon dhe informon mbi mbarëvajtjen e saj.</p>
---	--

Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.

<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Ky program studimi parashikon mbylljen e ciklit të studimit me temë diplome. Sipas informacioneve në vizitë, një muaj pas fillimit të vitit akademik, Përgjegjësi i Departamentit u bën të njohur studentëve, të cilët diplomohen atë vit, programin e temave të diplomave, me anën e të cilit do të bëhet vlerësimi përfundimtar. Struktura përgjegjëse pasi miraton aplikimin vendos udhëheqësin për punën kërkimore dhe tezën për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli.</p> <p>Gjatë takimit me PA e programit të studimit si dhe nga dokumentacioni i marrë gjatë vizitës, Departamenti Inxhinierive ka hartuar një listë ku për çdo student evidentohet udhëheqësi dhe tema e diplomës. Udhëheqësit e temave të diplomave kanë të paktën titullin Doktor.</p> <p>Departamenti i Inxhinierive në brezin e parë të të regjistruarve në MP</p>
---	--

	Sisteme të energjisë ka 31 studentë nga të cilët deri tani kanë marrë temë diplome 29 studentë(e dhënë e marrë gjatë vizitës). Udhëheqës të temave të diplomave janë pedagogë pjesë e PAE ose PAK dhe departamenti kujdeset që një udhëheqës të mos mbikëqyrë më shumë se 5 studentë njëkohësisht.
Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.	
Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.	Udhëheqësit e diplomave janë pedagogë PAE ose PAK nga Departamenti i Inxhinierive, me fushë studimore-kërkimore në lëmin e efciçensës së sistemeve të energjisë.
Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.	Udhëheqësit e diplomave zotërojnë njohuri teorike e praktike në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit sipas profileve specifike, që studenti zgjedh të trajtojë në temë.
Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;	Sipas informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion në takimin me stafin dhe në takimin me studentët, nga ana e AU ka një angazhim të mirë të personelit ndihmës mësimor për mbarëvajtjen e mësimit dhe mirëmbajtjen e ambienteve mësimore. Departamenti i Inxhinierive ka në përbërje të tij 1 anëtar të personelit ndihmës-akademik me karakter mësimor (laborant) me eksperiencë në fushën përkatëse, që mbikëqyr mbarëvajtjen e punëve laboratorike dhe kujdeset për mirëmbajtjen e laboratorëve.
Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	Institucioni përdor në mënyrë optimale burimet njerëzore për arritjen e objektivave për programet e studimit të ciklit të dytë, pasi ka 2 asistente departamenti dhe 1 sekretare mësimore për programet e studimit Master i Shkencave dhe Master Profesional (e cila zhvillon veprimtarinë nën kujdesin e kryesekretares së Fakultetit), veprimtaria e të cilave është në funksion të mbarëvajtjes akademike dhe administrative të këtyre programeve studimi. AU pranë bibliotekës së Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike ka angazhuar një punonjëse biblioteke, e cila mbikëqyr bibliotekën, ndihmon dhe orienton studentët në përdorimin optimal të materialeve mësimore të ofruara.
Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;	Në zbatim të udhëzimit Nr. 29, datë 10/09/2018 të MASR "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë", Senati Akademik i <i>Albanian University</i> ka marrë vendim, që ngarkesa mësimore vjetore për autoritetet drejtuese, personelin akademik me kohë të plotë, si dhe personelin akademik me kohë të pjesshme, të jetë në përputhje me nevojat e njëjësive bazë.
Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.	Sipas të dhënave në "Ngarkesa totale në auditor e stafit akademik për programin e studimit Master Profesional në "Sisteme të Energjisë" Viti Akademik 2018 – 2019", ngarkesa mësimore e stafit akademik PAE dhe PAK në këtë program studimi është konform udhëzimit Nr.29.
Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.	
Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;	Të gjitha të dhënat lidhur me anëtarët e personelit akademik ruhen dhe azhurnohen (të paktën një herë në vit) në arkivën e Departamentit, si dhe në atë të Burimeve Njerëzore. Nga vizita në Institucion me zyrën e Burimeve Njerëzore, Sekretarinë Mësimore e Përgjegjësin e Departamentit, u vërejt se ruhen informacionet lidhur me stafin akademik dhe personelin ndihmës-akademik me karakter mësimor e administrativ dhe ngarkesën përkatëse për
Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;	

<p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>çdo semestër të vitit akademik. Zyra e Burimeve Njerëzore në AU publikon vendet vakante dhe kriteret e punësimit për çdo pozicion pune vakant në faqen e internetit (vende vakante - link), si dhe në mjetet e tjera të informimit publik.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. AU në programin e studimit MP në Sisteme të Energjisë ka angazhuar PAE, PAK e personel ndihmës akademik me karakter mësimor e administrativ për arritjen e objektivave të këtij programi. Personeli akademik luan një rol aktiv në rishikimin e zhvillimin e kurikulave në përputhje me misionin e institucionit. 2. Rekrutimi i personelit akademik kryhet përmes procedurave transparente e konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi si dhe konform me vendimet e senatit të AU. 3. AU evidenton në bazën e të dhënave informacion për personelin akademik e ndihmës akademik sipas semestrave si dhe ngarkesën mësimore të tyre. Sipas RVB, ngarkesa mësimore për PAE e PAK në këtë program studimi i referohet Vendimit të Senatit të AU që i jep të drejtën departamenteve të ngarkojë personelin akademik sipas nevojave të Njësisë Bazë. Mendojmë që, bazuar në pikën 5 të Dispozitave të Fundit të Udhëzimit Nr.29 date 10/09/2018 të MASR, Institucioni i arsimit të Lartë jopublik mund të përcaktojë vetëm kufirin minimal të ngarkesës mësimore, pasi kufiri maksimal përcaktohet nga Kodi i Punës. 4. Për studentët e këtij programi studimi të ciklit të dytë ka përcaktuar në kohë temat e diplomave dhe udhëheqësit e tyre. Nga 31 studentë gjithsej, kanë marrë temë diplome 29 prej tyre. 	

4. **Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Në shërbim të programeve të studimit : Bachelor, Master i Shkencave dhe Master Profesional që mbulon Departamenti i Inxhinierive në AU është vënë në dispozicion ndërtesa e rikonstruktuar në Rrugën e Kavajës. Pas vizitës në të gjitha ambientet e saj, vihet re se kjo ndërtesë është e përshtatshme për universitet, me klasa, laboratorë, zyrë sekretarie, ambient për pedagogët, nyje hidrosanitare etj. Klasat janë me hapësirë dhe të pajisura me mjetet e nevojshme teknologjike (kompjuter, videoprojektor), tryeza pune. Laboratorët janë të pajisura me mjetet dhe aparaturat e nevojshme për kryerjen e punëve laboratorike të nevojshme për këtë program studimi. Për këtë program studimi ashtu si dhe për programet e tjera të studimit që mbështet Departamenti i Inxhinierive, ka në dispozicion sallën e internetit dhe bibliotekën, me orar të përcaktuar. Institucioni ka siguruar mjediset për Drejtuesin e Njësisë Kryesore dhe Administratorin e fakultetit si dhe zyra për Drejtuesin e Njësisë bazë të Inxhinierive dhe personelin akademik. Godina mbulohet nga rrjet interneti *wireless*, e disponueshme për të gjithë. Biblioteka e fakultetit është e hapur çdo ditë nga e mërkura në të premte 8.00 – 16.00, dhe ditën e shtunë 8.00 – 12.00. Në bibliotekë gjenden 104 tituj librash në fushat inxhinierike me 335 kopje (e dhënë për departamentin). Në të janë të instaluar 25 terminale të lidhura në një kompjuter qendror, të cilët vihen në dispozicion të studentëve, duke i mundësuar atyre kërkimin në internet dhe aksesimin e librarive *online* të këshilluara nga departamenti.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mbështetur në të dhënat e RVB si dhe nga informacioni i marrë gjatë vizitës në takimin me studentët dhe stafin akademik të programit të studimit MP në Sisteme të Energjisë, AU ka vënë në dispozicion të studentëve të programeve të ciklit të dytë Master i Shkencave dhe Master Profesional të Departamentit të Inxhinierive dhe

MP në Interior Design, Mjediset e godinës së rrugës së Kavajës për oraret e pasdites që fillojnë në orën 16.00 nga e hëna në të premte. Llogaritja e treguesit *ambiente[m²]/student* është bërë mbi këtë bazë. Të detajuara jepen në Tabelen 7. Sipërfaqja i referohet mjediseve që ndodhen në godinën e Rr. së Kavajës. Nuk është përfshirë Laboratori i Kimisë, i cili ndodhet në Godinën e ishHotel “Internacional”. Janë konsideruar të gjithë studentët e programeve të studimit Master i Shkencave/Master Profesional në Inxhinieri dhe Master Profesional në Interior Dizajn për vitin akademik 2018 – 2019, të cilët zhvillojnë mësimin gjatë pasdites dhe fundjavës. Nuk janë konsideruar studentët e programeve Bachelor në Inxhinieri (389 studentë) dhe studentët e programit të studimit Bachelor në Dizajn (76 studentë), të cilët zhvillojnë mësimin gjatë paradites nga e hëna në të premte.

Në llogaritjen e treguesit “Mjedise për stafin”, sipërfaqja totale e zyrave për personel akademik është 335.89m², nga të cilat 200,6m² janë mjedise që ndodhen në godinën qendrore në Blv. Zogu i I . Pra, 135,29m² janë ambienteve të vlefshme për stafin e dy prej departamenteve të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike në Godinën e rrugës së Kavajës. Numri I stafit përfshin stafin akademik PAE dhe PAK i Departamentit të Arkitekturës dhe Inxhinierive dhe personeli përkatës administrativ i çdo zyre, për vitin akademik 2018 – 2019. Treguesi “Mjedise për stafin” e programeve të studimit në departamentet e Arkitekturës e Inxhinierive do llogaritet si $135.29/78=1.73m^2/staf$.

Mjediset për Programin e studimit janë

- Salla për leksione
- Klasa për seminare
- Salla për aktivitete promovuese
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale
- Laboratorë për lëndët
- Laboratorë informatike
- Salla interneti
- Salla për bibliotekë
- Mjedis për fotokopjime, librari etj
- Zyrë informacioni për studentët
- Nyje hidrosanitare

Mjediset për stafin:

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin
- Zyra për sekretarinë mësimore
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore
- Zyra për personelin akademik

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	

<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p>	<p>Departamenti i Inxhinierive në AU ka një vendndodhje të përhershme pasi që nga hapja e tij në 2010, ka zhvilluar të gjitha aktivitetet me karakter mësimor e administrativ në mesin që ndodhet në Rr. e Kavajës. Institucioni AU e ka në përdorim për aktivitetin e tij këtë mesin, dhe së fundmi, kontrata e qerasë është rinovuar me kohëzgjatje 10 vjeçare [Evidencë 4.4]. Departamenti i Inxhinierive e ka organizuar aktivitetin mësimor e administrativ të programit të studimit Master Profesional në “Sisteme të Energjisë” në mesin e Rr. së Kavajës. Departamenti i Inxhinierive në AU ka marrëveshje me 25 kompani e biznese vendase në kuadër të praktikave mësimore me qëllim që të garantojë mjedis të mjaftueshme për realizimin e praktikave mësimore e profesionale të studentëve.[Evidencë 11.1]</p>
<p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p>	
<p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një mesin, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p>	
<p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedis të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	

Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, u konfirmua se Biblioteka e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, ku bën pjesë edhe Departamenti i Inxhinierive, vë në dispozicion të studentëve 104 tituj librash në fushat inxhinierike me 335 kopje. Në bibliotekë gjendet mbi 80% e literaturës në gjuhën shqipe, e detyruar në syllabuset e lëndëve. <i>Mendojmë që ky numër titujsh është i vogël për një fakultet me shumëllojshmëri programesh studimi e si pasojë nevojitet pasurimi i mëtejshëm i saj.</i> Sipas dokumentacionit në DA, kërkesa e fundit për pasurim bibliotekë nga Departamenti i Inxhinierive është në 2017 për 35 tituj, ku shumica janë tekste mësimore për lëndë të formimit bazë në programet bachelor. <i>Numri i teksteve të dedikuara për këtë program studimi është 4, pra mbetet një numër i vogël krahasuar me numrin e temave të diplomave që ky program studimi do mbështesë çdo vit akademik.</i> Në dispozicion të studentëve janë vënë disa librari online, të cilat përdoren nga studentët nën kujdesin e punonjësës së bibliotekës në qendrën e internetit. Personeli akademik që zhvillon programin e studimit MP në Sisteme të Energjisë kanë ofruar për studentët literaturë në formë leksionesh në formë hardcopy dhe në format elektronik. <i>Për realizimin me sukses të projekteve kërkimore-shkencore të kërkuara nga pedagogët në kuadër të mësimdhënies dhe në përgatitjen e tezës së diplomës, mendojmë që pasurimi i bibliotekës me tituj të rinj në mbështetje të këtij programi studimi duhet të vazhdojë të mbetet detyrë për departamentin.</i> Çdo fillim viti akademik, në përputhje edhe me rishikimet e syllabuseve, departamenti bën kërkesat e tij për shtimin e librave në bibliotekë, si në tituj edhe në numër. Në ambientet e fakultetit janë të shpallura oraret e bibliotekës që është e hapur çdo ditë nga e hëna në të premte 8.00 – 16.00, dhe ditën e shtunë 8.00 – 12.00. Studentët u shprehën se orari është i përshtatshëm për ta dhe se në bibliotekë marrin shërbimin në lidhje me materialet që iu këshillojnë pedagogët e lëndëve .</p>
<p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p>	
<p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p>	
<p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p>	
<p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedis të përshtatshëm mësimor.

<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p>	<p>Institucioni e plotëson këtë kriter pasi ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit për realizimin e këtij programi studimi. Mjediset ku zhvillohet aktiviteti mësimor janë me hapësirë e dritë, të përshtatshme për mësimdhënie . Nga shqyrtimi i listës së pajisjeve të laboratorëve konstatojmë se laboratorët kanë aparaturat dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e laboratorëve të nevojshëm për këtë program studimi. Institucioni e plotëson më së miri këtë kriter, pasi ka 9 laboratore: Laboratorët e Informatikës 1 – 2 (Simulimeve), Laboratori i Infrastrukturës së Rrjetave, Laboratori i Fizikës, Laboratori i Kimisë, Laboratori i Elektroteknikës, Laboratori i elektronikës analoge/laboratori i elektronikës dixhitale, Laboratori i matjeve elektrike dhe elektronike, Laboratori i automatikës dhe kontrollit (dhe Mekatronikës), Laboratori i makinave elektrike. Në vizitën e bërë në institucion konstatojmë se disponon 2 laboratore informatike me rreth 20 kompjutera në çdo laborator, që kanë të instaluar dhe programe kompjuterike të dedikuara për këtë program studimi, ku studentët zhvillojnë punët laboratorike (me simulime) dhe detyrat e kursit për lëndë të ndryshme në kujdesin e pedagogëve .</p>
<p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p>	
<p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p>	
<p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	

Konkluzione të GVJ:

1. *Institucioni ka bërë përpjekje për pasurimin e bibliotekës me literaturë bashkëkohore në gjuhë të huaj dhe shqip, si dhe zgjerimin e mjedisit të saj. Megjithatë, numri i titujve është ende i vogël dhe përpjekja për pasurim duhet të vazhdojë.*
2. Studentët merrnin leksione të printuara dhe në format elektronik nga pedagogët por institucioni nëpërmjet qendrës së botimeve që disponon, mund tu japë pëparësi botimeve për degët inxhinierike.
3. Departamenti ka bërë përpjekje për të përdorur librari elektronike më të përshtatshme për këtë program studimi.
4. Institucioni i plotëson kriteret e standartit V.2 pasi ka laboratorët e duhur dhe të pajisur me aparatura bashkëkohore për zhvillimin e laboratorëve në këtë program studimi.
5. Institucioni nuk ka mundësi të zhvillojë praktika profesionale në ambjentet e tij. Për këtë qëllim Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me kompani të ndryshme për zhvillimin e praktikave mësimore.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Burimet financiare të universitetit janë kryesisht nga tarifat e shkollimit dhe aktivitete të tjera tregtare të përmendura RVB. Nuk ka informacion të detajuar në lidhje me shpenzimin e të ardhurave. Në rang universiteti ka një njësi e cila merret me menaxhimin e burimeve financiare, dhe kontrollin e tyre. Institucioni ka një raport financiar, bilanc, për çdo vit buxhetor me të dhëna për të ardhurat nga tarifat e shkollimit, për pagat, sigurimet shëndetësore, sigurimet shoqërore, tatimin mbi të ardhurat personale, shpenzimet operative etj. Bazuar mbi kriteret e standardeve shtetërore të cilësisë ky Institucion ia ka dalë me sukses që të mbulojë me kosto financiare të gjitha shërbimet e kërkuara. Kostot operative vjetore ndryshojnë nga njeri program studimi tek tjetri, për shkak të veçorive që ka secili prej tyre. Burimet financiare janë kryesisht nga tarifat e shkollimit të studentëve. Nuk ka informacion të detajuar për shpenzimet që institucioni bën për qiranë e objektit dhe

shërbime të tjera të lidhura me të (mirëmbajtja, pastrimi, ngrohja, ftohja etj.). Një pjesë e burimeve nga të ardhurave shpenzohet për pagesën dhe sigurimet e punonjësve të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe për mbulimin e shpenzimeve që lidhen me reklamën, shërbimin internet, pajisjet e aparataturat, mjetet e konsumit dhe detyrimet ndaj shtetit. Të ardhurat dhe financimet në institucion regjistrohen, përpunohen dhe auditohen mbi bazën e një numri unik identifikues (NIPT-i) të lëshuar nga QKR. Në këtë mënyrë treguesit për të ardhurat dhe financimet nuk janë të veçuara për çdo program studimi.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje) (Tabela 8).

Sponsorizimi është bërë nga Idemia Aleat për Konferencën e 14të Ndërkombëtare “Standardization, Prototypes and Quality: A Means of Balkan Countries’ Collaboration”, 21 – 22 Shtator 2018

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik.

Shpenzimet që përfshihen në llogaritjen e koston së studimit lidhen me fondin e pagave, kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, honoraret në mësimdhënie, veprimtaritë shkencore, fondi i ekselencës dhe kosto të tjera të departamentit. Sipas RVB, kostoja për një student në programin e studimit *Master Profesional* në “Sisteme të Energjisë” është 124 000 lekë. Transparenca dhe kontrolli i brendshëm financiar kryhen nga Auditimi i brendshëm, ekspert kontabël, i cili harton Raportin e ekspertit kontabël dhe realizon auditimin e shoqërisë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfutuara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifatat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>AU ka në strukturën e tij Zyrën e Financës dhe Zyrën e auditit të brendshëm, me një ekspert kontabël të licencuar që bën raportet e auditimit të brendshëm ku jep informacion për situatën financiare, e cila bëhet mbi bilancin e çdo viti kalendarik [Evidencë 2.2].</p> <p>Raporti i auditit detajon të ardhurat (nga grantet , kontratat e shërbimeve për të tretë, nga tarifatat e studimit, nga subvencione, etj) dhe shpenzimet. Aktualisht universiteti nuk përfiton asnjë grant të huaj që përfitohet nga kontratat e shërbimeve.</p> <p>Raportet e auditit analizojnë përdorimin e të ardhurave, të cilat janë kryesisht nga tarifatat e shkollimit të studentëve, dhe një pjesë shumë e vogël, rreth 2.1% e fondit total vjen nga subvencioni për një Konferencë që ka zhvilluar DI.</p>
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Në vizitën e kryer në Institucion, mësuam se ka raport financiar për çdo vit buxhetor të hartuar , i cili është certifikuar nga auditues të jashtëm të licencuar, me të dhëna për tarifatat e shkollimit , për pagat, sigurimet shëndetësore, sigurimet shoqërore, tatimin mbi të ardhurat personale, shpenzimet operative etj.</p> <p>Në dosjen e akreditimit nuk është depozituar ndonjë raport i tillë, dhe të dhënat i janë referuar RVB.</p>

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Në RVB është dhënë informacion në lidhje me raportin financiar për vitin e fundit 2018-2019. Nga tabela 8 e RVB (me të dhëna vetëm për vitin 2018-2019), shihet qartë se Institucioni ka të ardhura të vetme ato nga tarifat e shkollimit. Institucioni nuk merr grante të huaja për kërkim, për konsulencë apo shërbime për të tretët, nuk ka sponsorizime për studentët apo për këtë program studimi, nuk kryen shërbime për të tretët, që ndikojnë në kualifikimin e vazhdueshëm të stafit.
2. Institucioni AU bën vlerësimin dhe dokumentimin e gjendjes së tij financiare dhe hartimin e raporteve financiare në mënyrë të përvitshme. Për koston e programeve të studimit, llogaritja është e paqartë, pasi raporti financiar mbahet në rang Universiteti dhe në raportin financiar zyrtar të hartuar nga eksperti i licensuar nuk ka të dhëna në lidhje me kostot e programeve të studimit bazuar mbi specifikat e seicilit. Sugjerojmë që raportet financiare të hartohen edhe mbi bazë fakultetesh në mënyrë që kostoja e programeve të studimit të llogaritet saktë dhe me transparencë.

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Albanian University ka ngritur Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë duke filluar që nga viti 2010, me Vendim Senati Akademik, nr. 178 dt. 23/07/2010 e më tej ka bërë përpjekje për të institucionalizuar këtë hallkë të rëndësishme të struktues së tij. Së fundmi, me Vendim Nr. 4 të Senatit Akademik dt. 22/12/2016 ka ngritur edhe Komisionin e Përhershëm për Vlerësim Institucional (KPI), i cili harton politikat e sigurimit të cilësisë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe Standardet Shtetërore të Cilësisë. Në statutin e AU në nenet 65, 66 dhe 67, shprehen atributet e detyrat e KPI dhe ZSBC. NjSBC funksionon edhe në nivel njësie bazë me ngritjen e grupeve të Sigurimit të Cilësisë brenda saj, me Vendim Senati Akademik Nr. 157/3 dt. 08/09/2016. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është në varësi të drejtpërdrejtë të Rektorit të Universitetit, dhe paraqit një raport vjetor me informacione dhe vlerësime për procesin e mësimdhënies, të kërkimit shkencor, cilësinë e shërbimit akademik dhe administrativ të ofruar, si dhe jep rekomandime për përmirësimin e parametrave të cilësisë në të ardhmen. Kjo mundësohet përmes aksesit në të gjitha informacionet e Universitetit, duke mundësuar në bazë të politikave dhe kriterëve të institucionit, sigurimin e brendshëm të cilësisë. NjSBC funksionon mbi bazën e Rregullores specifike për sistemin e Sigurimit të Cilësisë, dhe ushtron funksion mbështetës, këshillimor, bashkërendues, monitorues dhe administrativ me strukturat e tjera akademike dhe administrative të Universitetit. NjSBC në bashkëpunim me Komisionin për Vlerësim Institucional, harton politikat e vetëvlerësimit dhe përcakton dhe kriteret e vlerësimit që do të ndiqen, bën të mundur hartimin e anketimeve dhe modeleve të raporteve vlerësuese. Kështu, në nivel njësie bazë, në fillim të çdo viti akademik, gjatë procesit të mësimdhënies, dhe në përfundim të tij analizohen dhe vlerësohen programet mësimore, literatura dhe format e vlerësimit. Mbështetur në të dhënat statistikore, të mbledhura gjatë : anketimeve të studentëve, fokus – grupeve, raporteve të vetëvlerësimit të pedagogëve, raporteve semestrale dhe vjetore të njësisë bazë, rezultateve të arritura nga studentët, bëhet kontrolli dhe vetvlerësimi. NjSBC në bashkëpunim me njësitë bazë analizon të dhënat dhe nxjerr në pah çështjet dhe situatat për përmirësim, me qëllim rritjen e performancës së mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor.

Tregues të matshëm:

- Të dhëna për anëtarët e NjSBC. (Tabela 9)
- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NjSBC:

Si rregull realizohen 2 anketime në vit me studentët në përfundim të çdo semestri përpara sezonit të provimeve. Me studentët e këtij programi studimi është realizuar vetëm një anketim. Mbështetur në RVB dhe dukumentacionin në DA, gjatë vitit akademik 2018 – 2019, në semestrin e parë kanë marrë pjesë në anketim rreth 54.8% e studentëve të programin të studimit *Master Profesional* në “Sisteme të Energjisë”.

Të gjithë të dhënat e mbledhura nga pyetësorët janë përpunuar. Nga analiza e tyre (si dhe ballafaquar nga opinionet e studentëve në takimin me ta) ka rezultuar një vlerësim i përgjithshëm pozitiv i studentëve të programit të studimit *Master Profesional* në “Sisteme të Energjisë”, si për programin e studimit, stafin akademik edhe atë administrativ. Njohuritë teorike - praktike të marra përgjatë këtij masteri përputhen me pritshmëritë e tyre. Nga takimi me stafin e programit të studimit, doli se rezultatet e pyetësorit janë diskutuar në nivel njësie bazë duke ruajtur konfidencialitetin dhe janë përcjellur në njësitë kryesore, në NjSBC dhe Rektorat. Në semestrin pasardhës, sipas bisedës me përgjegjësin e departamentit, është synuar përmirësimi i çështjeve me probleme që kanë dalë nga pyetësorët si : problematika lidhur me stafin akademik, me literaturën , me përmirësimin e shërbimeve universitare në përgjithësi.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë .

Kontrolli i brendshëm i cilësisë vlerëson cilësinë e programeve të studimit dhe bëhet në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë vitit akademik, veçanërisht në përfundim të çdo semestri. Për këtë përdoren metodologji të ndryshme vlerësimi indikacionesh, si pyetësorë me studentët, fokus-grupe, raporte vetëvlerësimi të pedagogëve, etj. Këtë vit akademik është zhvilluar pyetësor edhe për pedagogët, ku ka marrë pjesë rreth 60% e PAK dhe 40.5% e PAE (në nivel institucioni). Të gjitha të dhënat e mbledhura pasqyrohen në raportet semestrale dhe vjetore të njësisë bazë dhe jepen rekomandime për përmirësime në të ardhmen.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti .

Për ruajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, NjSBC bashkëpunon me njësitë bazë nëpërmjet Grupeve të Sigurimit të Cilësisë të ngritura në nivel departamenti. Këto janë me përbërje nga stafi akademik i brendshëm i njësisë bazë, konkretisht 2 apo 3 pedagogë me tituj e me grada, të cilët punojnë për rishikimin e kurrikulave dhe syllabuseve në bashkëpunim me lektorët e lëndëve, si dhe janë pjesë e grupeve të vlerësimit të brendshëm në rastet e akreditimit të programeve të studimit.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre .

Në raportet semestrale që njësia bazë harton, përfshihen të dhëna përshkruese dhe sasiore mbi çështje që lidhen me gjendjen e programeve të studimit, vlefshmërinë e akreditimit, stafin akademik të rekrutuar, literaturën e re të hyrë në bibliotekë, rezultatet e arritura të studentëve, kalueshmëria dhe nota mesatare, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore dhe në fund paraqitet analiza SWOT, si dhe masat e marra për përmirësime në të ardhmen.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike realizohen kryesisht nëpërmjet pyetësorëve të studentëve, pedagogëve e takimet me focus grupet.

Në përfundim të tyre NjSBC harton raportin vjetor dhe e dërgon me shkresë pranë Rektoratit.

Rezultatet e auditimit dhe vlerësimeve të jashtme

Nga takimi me përgjegjës e Departamentit, referuar vlerësimit të jashtëm në kuadër të akreditimit institucional, u vlerësuan me nota pozitive sugjerimet e dhëna nga ekspertët e jashtëm në lidhje me trajtimin e aspekteve të caktuara për rritjen e cilësisë së programeve të studimit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të	AU përdor sistematikisht metodologji vlerësimi për ecurinë e programit të studimit bazuar në instrumenta matëse të ndryshme (pyetësorët) të cilët i

<p>studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj.); Dëgjime në auditor; Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuar me nota/pikë; Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale; Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.); Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës; Etj. 	<p>rinovon vazhdimisht, por edhe rezultatet e studentëve në fund të procesit mësimor. Informacioni i marrë nga pyetësorët me studentë, pedagogë e fokus grupet, përdoret nga institucioni për të bërë vetvlerësimin e për të rritur më tej cilësinë e programeve të studimit.</p> <p>Institucioni i publikon rezultatet e vlerësimit, në formën e broshurave, ku për çdo çështje të pyetësorit jepet me grafik mendimi i të anketuarëve. Gjithashtu, Institucioni në përfundim të çdo viti akademik publikon në faqen zyrtare të tij, raportin vjetor të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore – shkencore, raport ky i cili dërgohet edhe në MASR në përputhje me kërkesat e Ligjit 80/15.</p> <p>Sipas RVB dhe vizitës në institucion rezulton se, Institucioni nëpërmjet NjsBC-së përdor metoda të drejtpërdrejta dhe mjete të tërthorta vlerësimi.</p> <p>Të tërthorta:</p> <ul style="list-style-type: none"> Pyetësorë të studentëve (2 herë në vit), Fokus grupe (në muajin dhjetor), mbi vlerësimin e mësimdhënies, procesit mësimor, infrastrukturës, etj. Raporte vetëvlerësimi të pedagogëve (në përfundim të semestrit të parë dhe të dytë) <p>Të drejtpërdrejta:</p> <ul style="list-style-type: none"> Vlerësim me nota dhe pikë; Hartohen teste paraprake dhe përfundimtare; Bëhen vëzhgime gjatë kryerjes së praktikave dhe ushtrimeve.
<p>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>AU harton çdo fundviti akademik raportin e veprimtarisë mësimore e shkencore, analizën e programeve të studimit, veprimtarinë së kërkimit shkencor dhe elementëve të tjerë, pjesë e jetës universitare. Ky raport miratohet nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit të <i>Albanian University</i>, publikohet në faqen <i>web</i> dhe në përputhje me kërkesat e Ligjit 80/15 dërgohet në MASR.</p> <p>Në faqen zyrtare të AU ka informacion në lidhje me programet e studimit që mbulojnë Departamentet e fakulteteve, procedurat për transferim studimesh etj, por nuk ka info në format video e foto në lidhje me aktivitete që Fakulteti zhvillon në kuadër të vlerësimit të brendshëm.</p>
<p>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>AU ka paraqitur në DA raporte me analiza vjetore për vlerësimin e programeve të studimit. Për programin MP në Sisteme të Energjisë kjo analizë , do të bëhet në fund të vitit akademik.</p> <p>AU ka të dokumentuara në planet strategjike të institucionit në nivel universitet/fakultet/departament politikat e përmirësimit të programeve të studimit sipas kushteve të tregut të punës por edhe hapjen e programeve të</p>

	reja të studimit.
Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Sipas dokumentacionit paraqitur në DA, AU është vlerësuar nga ekspertet e ASCAL në bashkëpunim me QAA për akreditimin institucional, duke kaluar pozitivisht akreditimin institucional me kohëzgjatje 2 vjeçare, shprehur me Vendim të Bordit të Akreditimi nr. 90, dt. 20/10/2017.</p> <p>Institucioni për sigurimin e cilësisë, ka ngritur strukturat përkatëse NJSBC deri në nivel njësie bazë, të cilat merren me monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p> <p>NJSBC ndjek procedurat nëpërmjet përdorimit të instrumentave vlerësuese në përputhje me Manualin për "Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit".</p> <p>AU përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin e mbikëqyrjen e vazhdueshëm të programit të studimit e cila konsiston me NJSBC e shtrirë në të gjitha nivelet e institucionit.</p> <p>AU synon ta ndërgjegjësojë stafin dhe studentët për rëndësinë e rritjes së cilësisë në institucion duke i përfshirë në diskutimet për rishikimin e syllabuseve, përditësimin me literaturë bashkëkohore, ndryshimet në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Kjo realizohet në bashkëpunim edhe me Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave dhe Komisionin për Mësimin dhe Kurrikulat. Sipas takimeve gjatë viztës në institucion GVJ konstaton se AU në fillim të çdo viti akademik organizon javët orientuese ku sqaron studentët dhe stafin akademik mbi rëndësinë e vlerësimit të cilësisë dhe akreditimit të programeve të studimit. Avantazhet dhe disavantazhet që kanë këta të fundit nga vlerësimi cilësor dhe akreditimi i programeve të studimit dhe vlerësimi institucional.</p> <p>Institucioni ka në vëmendje përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë mësimore dhe kërkimore - shkencore që ofron dhe politikat që ndjek për këtë pasqyrohen në statut dhe janë të afishuara edhe në faqen zyrtare.</p>
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u>	
<ol style="list-style-type: none"> 1. NJSBC dhe përgjegjësi i departamentit përgatisin raporte semestrale e vjetore, mbështetur në formularët e vlerësimit për studentët dhe personelin akademik, ku evidentohet problematika e shfaqur në mësimdhënie dhe vështërsitë e hasura në realizimin e një mësimdhënie cilësore. 2. Janë bërë përpjekje dhe përmirësime por duhet vazhduar akoma më tej pasi rezultatet e marra nga analiza e vetevlerësimit të programit të studimit janë një shtysë e rëndësishme në ndërgjegjësimin e personelit akademik dhe të studentëve në lidhje me rritjen e cilësisë së programit të studimit, në mënyrë që studentët të përthithen sa më shpejt nga tregu i punës. 	

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Programi i studimit “Master Profesional në Sisteme të Energjisë” është në vartësi të Departamentit të Inxhinierive. Ai është hapur për herë të parë në vitin akademik 2018-2019 duke arritur një kuotë rregjistrimesh prej 31 studentësh. Kurrikula e këtij Programi studimi përfshin 11 lëndë të klasifikuara sipas gjurmës që lënë në formimin e studentëve në: lëndë të formimit bazë (A), të formimit karakterizues (B), dhe lëndë me zgjedhje (D), lëndë të informatikës dhe praktika mësimore (E). Në realizimin e kurrikulës mësimore janë angazhuar 4 pedagogë nga të cilët 3 janë personel akademik efektiv (PAE) dhe 1 është personel akademik me kontratë (PAK). Bazuar mbi modelin fillestar kurrikula nuk ka pësuar asnjë ndryshim.

Në analizën e bërë, konstatohet se kurrikula është hartuar nga një personel i cili ka përvojë pune si në fushën e energjisë, standarteve energjitike ashtu edhe në atë të mësimdhënjes. Lëndët janë përshtatur mirë me misionin dhe objektivat e institucionit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi i studimit ka filluar në vitin akademik 2018-2019 dhe është liçensuar me urdhërin përkatës të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë i cili mban datën 12/10/2018 dhe nr.674. Ky program mësimor ka për qëllim kualifikimin në fushën e energjisë. Programi jep njohuritë e nevojshme në projektimin, montimin dhe instalimin e sistemeve të ngrohjes ftohjes, sistemeve të ventilimit. Programi plotëson njohuritë e studentit në lidhje me standartet internacionale të përdorura në fushën e energjisë. Rëndësi e veçantë i kushtohet dhe rendimentit të sistemeve energjitike.

- Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- Programi i studimit shtrihet në një vit akademik me 30 javë mësimore në auditor.
- Programi i studimit është përbërë nga dy semestra dhe një semester ka 15 javë mësimore.
- Mësimi zhvillohet në semestrin e parë në 15 javë dhe në semestrin e dytë në 10 javë, ndërkohë që 5 javë të semestrit të dytë i janë rezervuar praktikës mësimore.
- Çdo semester ka 30 kredite.
- Ora mësimore (në auditor) është 50 min.
- Një kredit (ECTS) ka 25 orë pune të studentit.

- Planu mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë .

Planu mësimor sipas viteve akademike, ndarja në ECTS është dhënë në tabelën 10 të Aneks.

- Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- | | |
|-----------------|--|
| • Për leksionet | 7.5 orë në auditor dhe 17.5 orë punë e pavarur e studentit |
| • Për Seminaret | 8 orë në auditor dhe 17 orë punë e pavarur e studentit |
| • Për Ushtrimet | 15 orë në auditor dhe 10 orë punë e pavarur e studentit |
| • Për Labororet | 23 orë në auditor dhe 2 orë punë e pavarur e studentit |

- Për Praktikën Profesionale **20 orë** në auditor dhe **5 orë** punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar **2 orë** në auditor dhe **23 orë** punë e pavarur e studentit
- Detyra Projekte **2 orë** në auditor dhe **23 orë** punë e pavarur e studentit

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara.

Në programin mësimor të paraqitur nuk ka pasur ndryshime dhe modifikime të lëndëve krahasuar me programin e licensuar. Kjo për arsyen se është dhe viti i parë i hapjes së këtij programi. Prandaj tabela 11 e Aneks qëndron e pa plotësuar.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës.

Personeli akademik është i kualifikuar dhe mbulon fushat inxhinierike dhe kërkimore mbi të cilat është ngritur plani mësimor.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetësimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Analizë e cilësisë së syllabuseve

GVJ i shqyrtoi të gjitha syllabuset e lëndëve që përfshihen në kurikulën e programit të studimit “Master Profesional në Sisteme të Energjisë dhe gjeti që hartimi i tyre është bërë sipas formatit të kërkuar. Nga ana formale u konstatua mënyra e përcaktimit të karakterit formues të lëndës sipas klasifikimit nga A në E. Në programet e disa prej lëndëve është paraqitur në mënyrë të vençantë rubrika e ushtrimeve. Të gjitha lëndët mësimore kanë në strukturën e tyre labororet dhe seminarët. Sa i përket përmbajtjes së tyre GVJ vlerëson se ata e japin të plotë problematikën e lëndës duke iu përgjigjur objektivave të saj. Duke gjykuar që syllabuset janë në proces përmirësimi të vazhdueshëm rekomandojmë përshtatjen e tyre sipas kërkesave të tregut, zhvillimit të teknologjisë, propozimeve e sugjerimeve të studentëve.

Gjatë vizitës në ambientet e universitetit u shqyrtuan dhe materialet mësimore si dhe bibliografia nga ku ato janë tërhequr. Për të gjitha lëndët mësimore ekziston materiali në gjuhën shqipe si dhe bibliografi plotësuese në gjuhë të huaj. Studentët e marrin informacionin në bibliotekë. Të gjitha materialet didaktike për masterin profesional në Sisteme të Energjisë ishin të dokumentuara në CD, të cilën studentët mund të merrnin në përdorim.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	

<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi MP në Sisteme të Energjisë vlerësohet me qëllim akreditimin e tij.</p> <p>Programi mësimor MP në Sisteme të Energjisë është i vlerësuar në kredite sipas sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve. Mënyra e përcaktimit të krediteve është realizuar përputhje me kriteret e sipër përmendura.</p> <p>Sasia mesatare e 26 krediteve të grumbulluara në një vit akademik është 60 (kredite). Masteri profesional zhvillohet gjatë një viti akademik.</p>
<p>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	




<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinar, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Bazuar në strukturën e lëndëve mësimore rezultojnë se programi i MP në Sisteme të Energjisë është i orientuar me qëllim thellimin e njohurive në fushën e projektimit menaxhimit dhe rendimentit të formave të energjisë veçanërisht asaj termike. Programi ofron mundësinë e thellimit të njohurive në fushën e burimeve energjitime, prodhimit, menaxhimit dhe rendimentit të po këtyre burimeve. Programi ofron njohuri ndihmëse për burimet e energjisë alternative, modelet matematike, standardet e përdorura në fushën e mbrojtjes së ambientit, etj.</p> <p><i>Programi nuk ofron njohuri të thelluara në fushën e sistemeve të energjisë elektrike si dhe në automatizimin e proceseve energjitime. Prodhimi, kontrolli dhe menaxhimi i energjisë elektrike nuk janë pjesë e orientimit të programit.</i></p> <p>Bazuar në programin mësimor të ofruar nga fakulteti i inxhinierive, specializimi MP në Sisteme të Energjisë u ofrohet studentëve të cilët kanë mbaruar ciklin e parë të studimeve “Bachelor” në Inxhinieri Elektrike dhe Elektronike, Energjitikë Profil i inxhinierisë Mekanike si dhe grupe të interesit të cilët kanë si qëllim të thellojnë njohuritë e tyre në fushën e prodhimit, projektimit dhe menaxhimit të sistemeve energjitime për efekte termike.</p> <p>Ky program mësimor i pajis studentët me njohuri të thelluara në fushat e sipër përmendura (prodhimit dhe menaxhimit të energjisë termike dhe metodave të gjenerimit). Si rezultat pas përfundimit me sukses të ciklit të dytë të studimeve ata (studentët) janë të aftë të ushtrorin të drejtën e profesionit të rregulluar sipas ligjeve në fuqi.</p> <p>Bazuar në syllabuset e lëndëve rezultojnë se programi i studimit MP në Sisteme të Energjisë i ofruar nga AU siguron njohuri të qëndrueshme në fushën e prodhimit dhe menaxhimit të sistemeve energjitime dhe i aftëson studentët në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>
<p>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodave të vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Programet e ofruara në ciklin e dytë të studimeve synojnë të kompletojnë studentët me njohuri të thelluara në një prej fushave të energjisë e cila njihet dhe specifikohet si profili i inxhinierit energjitik.</p> <p>Bazuar në kontrollin e ushtruar në lidhje me mënyrën e organizimit të procesit mësimor si dhe të mënyrës së vlerësimit arrijmë në konkluzionin që metodat e vlerësimit dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentit gjatë ciklit mësimor.</p>
<p>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disa vjeçare dhe praktikën e mira të vendeve evropiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e</p>	<p>Nga ndërthurja e lëndëve mësimore, organizimi dhe numri i krediteve 27 u përcaktua se programi mësimor është mbështetur në praktikën e MP Inxhinierisë Mekanike profili Energjitikë. Nga takimi me stafin akademik u tha se për ndërtimin e syllabusa-ve grupi i pedagogëve përgjegjës është konsultuar me disa prej programeve mësimore të zbatuara në fakultetet e rajonit, si dhe në atë të Universitetit Politeknik Tiranë.</p> <p>Bazuar në syllabuset e lëndëve, metodat e vlerësimit të studentëve, objektivave të vendosura dhe kërkesave për ti realizuar ato rezultojnë se programi i studimit MP</p>

<p>arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>në Sisteme të Energjisë është konkurrues me programet e studimit MP të drejtimin energjitikë të universiteteve të tjerë. Ndërthurja e lëndëve në program e bën atë të veçantë, krahasuar me programet e tjera (të ngjashme) të studimit.</p> <p>Hartimi i programit të studimit është mbështetur në objektivat, legjislacionin, standardet e BE për sistemet e energjisë termike dhe energjisë së rinovueshme. Programi i studimit përkon me profesionin e rregulluar inxhinier energjitik. Ky profil inxhinierik njihet dhe në vendet e BE.</p>
<p>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Programi i studimit MP në Sisteme të Energjisë përfshin aftësimin profesional në fushën e prodhimit, menaxhimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve energjetike.</p> <p>Programi i studimit është miratuar në përputhje me profilin e AU dhe strategjinë e tij për zhvillim.</p> <p>Personeli akademik (me kohë të plotë dhe kohë të 28 pjeshëshme) është i angazhuar për realizimin e programit të studimit MP në Sisteme të Energjisë .</p> <p>Duke u bazuar në CV-të personale si dhe në botimet e publikuara rezultojnë se puna kërkimore e personelit akademik (me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme) është e orientuar në përputhje me kërkesat e programit mësimor.</p>
<p>Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>Programi i studimit MP në Sistemet të Energjisë ofrohet në përputhje me kërkesat e tregut të punës për inxhinierë dhe specialistë në fushën e sistemeve energjetike sidomos për sistemet e konvertimit të energjisë (energji termike në energji elektrike, etj.)</p> <p>Sektori i industrisë në të cilin studentët e diplomuar në MP do të inkuadrohen është ai i sistemeve energjetike (konvertimi i energjisë, transmetimi i energjisë termike) dhe sektori i energjisë së rinovueshme, (sektori i energjisë djellore, termale dhe elektrike)</p>
<p>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Programi i studimit është hartuar në përputhje me kërkesat dhe kriteret e tregut të punës në Shqipëri. Programi hartuar është në përputhje me strategjinë e zhvillimit të sistemeve energjetike të Republikës së Shqipërisë dhe më tej.</p> <p>Institucioni ka kryer një studim dhe vlerësim të nevojave të tregut të punës për inxhinierë me specializimin inxhinier energjitik. Ky studim është bazuar në numrin e lartë të kërkesa të tregut të punës për këtë profil, kërkesat e vazhdueshme për investime në sistemet energjetike si dhe në nevojat e vazhdueshme për përdorimin e energjive jo konvencionale në sistemet termike (energji diellor ajo gjeotermale, etj). [Raport mbi studimin e tregut në Fushën e Sistemeve të Energjisë]</p>
<p>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i studimit MP në Sisteme të Energjisë i ofruar nga AU është një program studimi me qëllim kualifikimin e studentëve në sektorin energjitik. Sektori energjitik është një sektor me interes kombëtar të veçantë prandaj dhe programi i studimit nuk mund të bjerë ndesh me interesat kombëtare.</p> <p>Mënyra e realizimit të kurrikulës jep origjinalitetin dhe përshtatjen në funksion të interesave kombëtare. Programi i ndërtuar synon ruajtjen e vlerave kulturore</p>

	kombëtare.
Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.	
Kriteri 1 Programet e studimeve "Master i Shkencave" realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;	N/A
Kriteri 2 Programet e studimeve "Master Profesional" realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.	Programi mësimor i ofruar në nivelin e dytë të ciklit të studimeve përfundon me projektin e diplomës. Projekti synon konsolidimin e njohurive të studentit në fushën e energjistikës. Teza e diplomës ka 6 ECTS dhe kohëzgjatja normale e programit mësimor është 1 vit akademik dhe 60 kredite
Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës "Master i Shkencave". Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).	N/A
Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.	
Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshëm për studentët; Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.	Nga anketimi i studentëve rezulton se programi i studimit dhe syllabuset janë të konsultueshëm për studentët. Gjatë vizitës në institucion, (Në bibliotekën e institucionit) u konsultuam me materialet didaktike të programit të studimit. Për të gjitha lëndët e programit të studimit ekzistonte bibliografia e nevojshme. Leksionet e lëndëve, materialet mbështetëse të tyre si dhe shembuj dhe ushtrime të ndryshëm ishin të arkivuara në një CD në formën e formatit PDF dhe Power Point. Studentët kishin aksesin në marrjen, kopimin dhe printimin e materialit të CD-së. Gjithashtu në bibliotekë ndodheshin librat (në format të shkruar) nga ku ishin tërhequr dhe materialet e leksioneve. Programi MP në Sisteme të Energjisë i ofruar nga AU ofrohet në të gjitha format. (si në formën e shkruar ashtu dhe në atë elektronike)
Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.	
Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar; Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve "Master i Shkencave" janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.	Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit por nuk mund të verifikohet pasi institucioni nuk ka ende studentë të diplomuar në këtë program studimit. Programi i studimit ka të parashikuar 6 kredite për projektin kërkimor por nuk mund të verifikohet puna kërkimore e studentit si dhe etapat e zgjedhura për realizimin e saj pasi universiteti nuk ka studentë të diplomuar në këtë program studimi.
Konkluzionet e vlerësimit:	
1. Nga informacioni i siguruar si dhe nga verifikimi i syllabuseve, programit mësimor rezulton se: Programi mësimor i ofruar në ciklin e dytë të studimeve MP në Sisteme të Energjisë përmbush qëllimin e hapjes së tij. Programi ofron njohuri të thelluara në fushën e prodhimit menaxhimit dhe mirëmbajtjes të sistemeve të prodhimit të energjisë termike. MP në Sisteme të Energjisë brenda kufirit të ligjit të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë duhet të përcaktojë dhe orintimin e njohurive të thelluara.	

2. Kriteret e vendosura në planin mësimor, strategjia e përcaktuar si dhe qëllimi i MP përkon me strategjinë kombëtare të zhvillimit të sistemeve të energjisë termike dhe metodave të gjenerimit të saj. Studentët pajisen me njohuri të thelluara për të qënë menaxhues të mirë të sistemeve energjetike si dhe të burimeve të prodhimit të tyre. *Për të pajisur studentët me njohuri të thelluara në fushën e projektimit të sistemeve enegjitike Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Departamenti i Inxhinierive duhet të shtojnë disa lëndë më specifike fushën e projektimit të cilat mund të jepen si lëndë me zgjedhje. Lëndët që ndihmojnë janë normat dhe standardet e zbatuara në projektimin e sistemeve energjetike (lëndë e cila jepet), modelet matematike të avancuara rregjimet dinamike të sistemeve energjetike metodat probabilistike në kontrollin e energjisë.*
3. Programi mësimor është i mbështetur plotësisht në kriteret e vendosura për hapjen e ciklit të dytë të studimeve MP. Mënyra e organizimit të diplomës në përfundim të ciklit të dytë është në përputhje me kriteret e vendosura, por verifikimi i mënyrës së organizimit dhe punës kërkimore të studentit nuk ka qënë i mundur për arsye se AU nuk ka studentë të diplomuar në ciklin e dytë të studimeve (MP në Sistemet e Energjisë).

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Gjatë vlerësimit u verifikua organizimi i procesit të mësimdhënies në MP në Sisteme të Energjisë, kohëzgjatja e procesit mësimor, kohëzgjatja e punimit të temës së diplomës (theksojmë se AU nuk ka studentë të diplomuar në MP në Sisteme të Energjisë). Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion procesi i mësimdhënies për programin e studimit MP në Sisteme të Energjisë është i organizuar në një vit akademik ose dy semestra, me kohë të pakufizuar për diplomim. Lënda zhvillohet në bazë të syllabusit dhe planit mësimor të miratur. Syllabuset e lëndëve përditësohen në tematikat që do të zhvillohen gjatë semestrit, literaturën e rekomanduar, mënyrën e organizimit të mësimdhënies dhe format e kontrollit dhe kriteret e vlerësimit. Veprimtaritë akademike për zhvillimin e lëndëve përfshijnë kombinimin e formave të ndryshme të mësimdhënies (leksione, seminare, ushtrime, laboratorë, detyra/projekte kursi, provimet e ndërmjetme, provimin përfundimtar dhe praktika profesionale. Ndarja në kredite për secilën formë janë të 30përcaktuara në programin e lëndës. Vlerësimi i studentëve bëhet sipas rregulloreve. Vlerësimi i studentit është i vazhduar dhe i ndarë në disa komponentë. Praktika profesionale zhvillohet nga studenti në 5 (pesë) javët e fundit të semestrit të fundit, në bazë të rregullores së përcaktuar. Praktika profesionale zhvillohet pranë kompanive që AU ka marrëveshje bashkëpunimi. Gjithashtu studentëve u caktohet një pedagog i cili ndjek ecurinë e studentit gjatë zhvillimit të praktikës. Studimet në këtë program studimi përfundojnë me punimin e temës së diplomës e cila mbrohet përpara një komisioni.

Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi që leksionet zhvilloheshin në ambiente të përshtatshme ku shpjegimi realizohej si me mënyrën tradicionale ashtu edhe me përdorimin e videoprojektorit dhe programit PowerPoint. Studentët i vlerësonin shpjegimet si të kuptueshme dhe nuk paraqitën ndonjë vërejtje lidhur me to. Edhe ushtrimet ishin në funksion të konkretizimit të njohurive të fituara gjatë leksioneve duke e vënë studentin jo vetëm në kushtet e riprodhimit por edhe në ato të kreativitetit. Punët laboratorike, zhvilloheshin në përputhje me tematikat e leksioneve, duke i bazuar në programet e simulimit. Për përvetësimin e njohurive, studentëve u viheshin në dispozicion leksionet e shkruara, ushtrimet e zgjidhura, udhëzuesit për punët e laboratorit si dhe literatura.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:

- Leksione
- Seminare
- Ushtrime
- Laboratore
- Praktikë lëndore
- Praktikë profesionale
- Etj

Nga vizita në institucion si dhe nga konsultimi me dokumentacion e ofruar GVJ konstatohet se lëndët mësimore të MP kanë në përbërjen e tyre leksione, seminare, ushtrime, laboratore dhe detyra kursi. Të dhënat e raportuara nga GVB përputhen me verifikimin e kryer në institucion. Për secilën prej formave të mësimdhënies janë parashikuar orë në auditor dhe jashtë tij. *Shpërndarja e orëve në auditor dhe orëve jashtë tij e paraqitur në tablën e GVB është bërë në përputhje me udhëzimin Nr.15 datë 04,04,2018 "Për organizimin e studimeve në institucionet e arsimit të lartë"*

Format e kontrollit të njohurive

Format e kontrollit të njohurive janë disa. Njohuritë e studentit verifikohen në funksion të pjesëmarjes dhe aktivizimit, dorëzimit e detyrave të kursit, vlerësimi gjatë zhvillimit të punëve të laboratorit, nga provime të ndërmjetme si dhe nga provimi përfundimtar. Nga kontrolli i dokumentacionit të ofruar si dhe nga verifikimi i shënimeve të pedagogëve në rregjistrat personalë dhe në rregjistrin e shkollës u konstatua se nuk ka ndryshime nga forma e verifikimit të studentit e paraqitur nga grupi i vlerësimit të brendshëm.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Departamenti i inxhinierive ka organizuar aktivitete me karkater shkencor. Në këto aktivitete kanë marrë pjesë dhe studentë të MP të Sistemeve të Energjisë. Nga verifikimi i dokumentacionit u konstatua se të dhënat e paraqitura nga GVB përputhen me të dhënat reale. Në aktivitetin e zhvilluar janë aktivizuar gjithësej 4 studentë të MP.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Studentët në Programin e Studimeve MP në Sisteme të Energjisë në AU janë rregjistruar për vitin akademik 2018-2019 dhe janë rregjistruar gjithësej 31 vetë. Koha e zgjatjes së studimeve është një vit. Frekuentimi është i detyrueshëm në masën 20% të leksioneve e ushtrimeve dhe në masën 80% për labororet. Nga 31 studentët e rregjistruar në vitin 2018-2019 nuk mund të verifikohet nëse rezulton ndonjë student ngelës ose jo për arsyen se është viti i parë akademik për këtë program studimi si dhe viti akademik është në vazhdimësinë e tij. Diplomimi i studentëve bëhet në periudhën qershor- korrik të po këtij viti akademik. Këtej do dalin dhe të diplomuarit e parë të këtij Programi studimi.

Të gjithë informacionin lidhur me programin e studimit, studentët e merrnin edhe në formën e formateve fizike: guida, rregullore, fletë palosje, njoftime të shpallura në mjediset e Universitetit si orari i mësimëve, fragmente rregulloresh etj. por edhe në formatet elektronike, duke përdorur për këtë qëllim dhe faqen e internetit. Ecuria e studentëve në procesin mësimor dokumentohej në dokumentacionin që iu vu në dispozicion GVJ gjatë vizitës së tij tek Sekretaria mësimore. GVJ shqyrtoi "Rregjistrin Themeltar të Studentëve" dhe "Rregjistrin e Matrikulimit". Në këto rregjistra gjendeshin të gjitha të dhënat e studentëve si dhe marrdhënia e tyre me institucionin. Plotësimi i tyre ishte konform kërkesave ligjore. U kontrolluan në mënyrë rastësore edhe dy dosje dokumentacioni të studentëve dhe në to u gjetën dokumentat: Fotokopje e Kartës së Identitetit, Fotografi personale Diploma e shkollës së mesme+ listën e notave, Diploma e Ciklit të parë të studimeve (Bachelor),

Certifikata familjare, Deklarata e rregjistrimit, Kontrata e studimeve. Studentët e rregjistruar ishin në përputhje me kriteret dhe kërkesat e hapjes së MP.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

Për tu rregjistruar në programin e studimit MP në Sisteme të Energjisë nuk janë parashikuar kushte specifike. Në këtë program mund të rregjistrohen studentë të cilët kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve, pra kanë një diplomë bachelor (të nivelit të parë) në një nga degët e inxhinierisë: Mekanike, Mekatronike, Elektrike, Ndërtimi dhe Arkitekturë. Studentët të cilët kanë përfunduar ciklin e parë jashtë profileve të sipër përmendur me rregullore i nënshtrohen procesit të njohjes dhe ekuivalentimit të lëndëve mësimore. Për këtë qëllim departamenti ngre dhe një komision të posaçëm, që kryen njohjen dhe transferimin e krediteve.

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Nota mesatare nuk është një parakusht në rregjistrimin e studentëve për programin e studimit MP në Sisteme të Energjisë. Nga verifikimi i dokumentacionit u vërejt se nota mesatare e studentëve të rregjistruar ishte nota 6 (gjashtë). Nuk mund të diskutojmë cilsinë e studentëve të diplomuar për arsyen se ky është dhe viti i parë akademik i këtij programi studimi.

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë).

Numri i studentëve të regjistruar në vitin e parë dhe për për herë të parë është paraqitur në tabelën 17, të Aneks

Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse).

Programi i studimit nuk ka studentë të diplomuar. Viti i parë i hapjes së programit të studimit është viti akademik 2018-2019.

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Bazuar në verifikimin e rregullares së AU u vërejt se universiteti mundëson transferimin e studentëve në vite ndërmjetëse brenda ciklit të dytë. Transferimi i studentëve mundësohet si brenda ashtu dhe jashtë IAL, publik apo privat. Për programin e studimit MP në Sisteme të Energjisë nuk ka pasur mobilitet të studentëve midis AU dhe institucioneve të tjera të arsimit të lartë.

Të dhëna për punësimin e studentëve

AU ka informacion në lidhje me punësimin e studentëve të cilët kanë përfunduar studimet pranë tij. Për studentët e MP Sisteme të Energjisë nuk është krijuar akoma baza e të dhënave për arsye se është viti i parë i studimeve dhe studentët nuk janë diplomuar akoma. Megjithatë nga verifikimi u vërejt se një pjesë e studentëve janë në marrëdhënie pune. *Nga GVJ u sygjeruar krijimi i një databazë për të dhënat për punësimin e studentëve për këtë program studimi.*

Numri total të diplomuarve

Programi i studimit MP në Sisteme të Energjisë nuk ka studentë të diplomuar. Diplomimi i studentëve të parë do të bëhet në periudhën qershor – korrik 2019.

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

Mëqënëse nuk ka studentë të diplomuar nuk mund të flasim për të dhëna zyrtare të punësimit të studentëve në përputhje me diplomën.

Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

Mëqënëse nuk ka studentë të diplomuar nuk mund të flasim për të dhëna zyrtare të punësimit të studentëve jo në përputhje me diplomën.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve "Master i Shkencave" apo "Master Profesional" zotërojnë së paku diplomën universitare "Bachelor" dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve "Master Profesional" niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve "Master i Shkencave" dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit të rregjistrimit të studentëve (dosjet e studentëve) rezulton se studentët të cilët ndjekin studimet në programin MP në Sisteme të Energjisë në AU zotërojnë diplomën e ciklit të parë të studimeve Bachelor në një prej degëve të inxhinierisë (Mekatronike, Elektrike, Elektronike, Ndërtimi, Arkitekturë) dhe kanë të grumbulluar 180 kredite ECTS për ciklin e parë të studimeve.</p> <p>Studentët të cilët nuk zotërojnë diplomën Bachelor sipas kriterit të përcaktuar i nënshtrohen verifikimit nga komisioni i Njohjes dhe Ekuivalentimit.</p> <p>Nga verifikimi i dokumentacionit të pranimit rezulton se dosja e studentëve është në përputhje me kriteret e pranimit të institucionit dhe ligjit të arsimit të lartë. Në dosje ekziston materiali i cili vërteton diplomën e ciklit të parë, kërkesën për tu pranuar në ciklin e dytë, kontratën e nënshkruar midis studentit dhe institucionit, etj. Pranimi i tyre është kryer në përputhje me ligjin e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>Studentët plotësojnë kushtet e pranimit të përcaktuara nga institucioni i arsimit të lartë (AU).</p> <p>Intervali kohor që institucioni ofron programin e studimit MP në Sisteme të Energjisë është shumë e shkurtër prandaj nuk mund të flasim për modifikim të politikave dhe kriterëve të pranimit. Grupi i vlerësimit arriti në konkluzionin se politikat e pranimit janë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të ligjit për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë. Ndërkohë që një numër i lartë studentësh do të çonte në forcimin e mëtejshëm të kriterëve të pranimit nga institucioni.</p>
Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>AU ka organizuar seminare të hapura me qëllim afrimin e kompanive me institucionin dhe studentëve me tregun e punës. AU ka ngritur zyrën e Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentëve. Për të krijuar një ide në lidhje me mundësitë e punësimit pas diplomimit studentëve u vihet në dispozicion dhe "Udhëzuesi për zhvillimin e Karrierës".</p> <p>Studentët e pyetur nga grupi i vlerësimit kanë qënë të informuar në lidhje me programin e studimit si dhe etapat që po ndjek universiteti për akreditimin e ciklit të dytë të studimit.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion dhe gjatë takimeve me personelin jo akademik të institucionit rezultoj se AU ka zyrën e këshillimit të karrierës. Por nuk mund të flasim për rezultate të këtij programi studimi për sa kohë AU nuk ka studentë të diplomuar në ciklin e dytë. (MP në Sisteme të Energjisë).</p>
Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	

<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Institucioni nuk disponon një statistikë vjetorë për numrin e studentëve të diplomuar në programin e studimit MP në Sisteme të Energjisë (për arsytet e përmendura më lart)</p> <p>Universiteti disponon data bazën e nevojshme për programin e studimit. Në data bazë ndodhen të gjitha të dhënat për studentët e regjistruar në programin e studimit MP në Sisteme të Energjisë.</p> <p>Gjatë verifikimit të dokumentacionit në sektretarinë mësimore u vërtetua se AU disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve të pranuar në programin e studimit MP në Sisteme të Energjisë. Të dhënat në lidhje me ecurinë vjetore të studentëve janë të arkivuara në format elektronik si dhe në format të shkruar (në regjistër të shkruar)</p>
<p>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Institucioni nuk disponon një bazë të dhënash të studentëve të punësuar, kjo për arsytet e përmenduar më sipër (koha kur është hapur programi i studimit – universiteti nuk ka akoma studentë të diplomuar studentë për këtë fushë studimi)</p> <p>Programi më i lartë i studimeve që ofrohet nga Departamenti i Inxhinierive në AU është cikli i dytë i studimeve, prandaj institucioni nuk ka bazë të dhënash për ciklin e tretë të studimeve.</p>
<p>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Nga biseda me studentët dhe personelin akademik ndihmës rezulton se AU (Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike) informon studentët në mënyrë të detajuar dhe transparente në lidhje me programin e studimit (MP në Sisteme të Energjisë) kohëzgjatjen si dhe me ecurinë e procesit të akreditimit.</p> <p>Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit. Vlerësimi kryhet në mënyrë transparente dhe studentët gëzojnë të drejtën e njohjes dhe konspektimit të tezës së provimit dhe mënyrë së vlerësimit. Rezultatet e vlerësimeve diskutohen me studentët nga personeli akademik.</p>
<p>Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Gjatë bashkëbisedimit me studentët u verifikua se institucioni ofron këshillimin e studentëve konsultimet dhe trajtimin e problemeve që lindin gjatë ecurisë së procesit mësimor.</p> <p>Gjatë bisedës me antëaret e zyrës së këshillimit të karrierës u verifikua se një prej detyrave të kësaj zyre është dhe dhënia e informacionit për studentët për të përzgjedhur institucionet ku ata do të kryejnë praktikën mësimore. Gjithashtu zyra ndihmon studentët në plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për kryerjen e praktikës.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p>	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Nga verifikimi i dokumentacionit të pranimit të studentëve rezulton se AU respekton kriteret ligjore të pranimit të studentëve në ciklin e dytë të studimeve MP. Kriteret e pranimit janë në përputhje me statutin e AU dhe ligjin e arsimit të lartë. Cikli i dytë i studimit MP në Sisteme të Energjisë ofrohet në një kohë të shkurtër dhe institucioni nuk ka studentë të diplomuar prandaj nuk mund të arrijmë në konkluzione në lidhje me punësimin dhe ndryshimin e kriterëve të pranimit të studentëve. 2. AU ka një politikë transparente në lidhje me mënyrën e vlerësimit të studentëve. Në përputhje me statutin dhe qëllimin e tij AU ofron konsultime me studentët e ciklit të dytë për problemet që ata hasin gjatë procesit mësimor. 	

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Bazuar në matialin e vlerësimit të brendshëm si dhe gjatë verifikimit rezulton se AU është një institucion i orientuar nga mësimdhënia dhe kërkimi shkencor. Kërkimi shkencor është pjesë e punës e stafit akademik me qëllim rritjen e vlerave të institucionit dhe kontributin e tij në zhvillimin e shkencës në Shqipëri. AU ka të hartuar politikën e vet për financimin e projekteve dhe kërkimeve shkencore. Nga verifikimi i dokumentacionit si dhe gjatë bisedës së zhvilluar me Dekanin dhe anëtarët e departamentit, rezultoj se Departamenti i Inxhinierive i cili ka nën administrim programin mësimor të MP në Sistemen të Energjisë është pjesë e projekteve Erasmus+ dhe EUSEW 2018 dhe EUSEW 2019. Si rezultat i këtyre projekteve është krijuar mundësia e lëvizjes së një pedagogu dhe tre studentëve. Gjithashtu gjatë periudhës 2017 dhe në vazhdim departamenti ka zhvilluar konferenca, leksione të hapura dhe workshop-e. AU dhe departamenti i inxhinierive është pjesë e disa rrjetave shkencore NetCO, ETEC dhe CADASA.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor

Nga verifikimi GVJ rezulton se pedagogët e Departamentit të Inxhinierive kanë pasur aktivitet shkencor dhe punime shkencore. Pjesëmarrja në programet Erasmus+ dhe EUSEW ka krijuar mundësinë e zhvillimit shkencor. Nga dokumentacioni i verifikuar rezulton se në konferencat e zhvilluara dhe në leksionet e hapura ka marrë pjesë anëtarët e departamentit të inxhinierive si dhe pedagogët përgjegjës për programin MP në Sisteme të Energjisë.

Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL

Nga verifikimi i dokumentacionit GVJ konstatohet se për vitin akademik 2017-2018 se personeli akademik efektiv i IAL ka publikuar 60 punime shkencore. Ky rezultat përputhet dhe me informacionin e përfutur nga raporti i GVB.

Numri i projekteve kërkimore të fituara

Nga verifikimi i dokumentacionit GVJ konstatohet se numri i projekteve kërkimore të fituara është në total 8 (tetë). Ky rezultat përputhet dhe me informacionin e përfutur nga raporti i GVB.

Numri i projekteve të zbatuara

Nga verifikimi i dokumentacionit GVJ konstatohet se numri i projekteve kërkimore të fituara është në total 9 (nëntë). Një prej projekteve ka qënë projekt individual. Ky rezultat përputhet dhe me informacionin e përfutur nga raporti i GVB.

Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL

Nga verifikimi i dokumentacionit GVJ konstatohet se numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL për programin e studimit është 4 (katër). Ky rezultat përputhet dhe me informacionin e përfutur nga raporti i GVB.

Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL

Nga verifikimi i dokumentacionit GVJ konstatohet se numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL është 25. Ky rezultat përputhet dhe me informacionin e përfutur nga raporti i GVB.

Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor

Nga verifikimi i dokumentacionit GVJ konstatohet se numri i kërkimit shkencor në aktivitetin mësimor është 85. Në këtë grup bëjnë pjesë diplomat e parashikuara për tu mbrojtur në vitin akademik 2018-2019. Ky rezultat përputhet dhe me informacionin e përfutur nga raporti i GVB.

Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor

Nga verifikimi i dokumentacionit GVJ konstaton se numri total i studentëve pjesë e departamentit të inxhinierive të përfshirë në kërkimin shkencor është 15. Ky rezultat përputhet dhe me informacionin e përftuar nga raporti i GVB.

Numri i Çmimeve Kombëtare

Nga verifikimi i dokumentacionit GVJ konstatohet se numri se IAL në veprimtarinë e tij kërkimore nuk ka fituar çmime kombëtare dhe ndërkombëtare. Ky rezultat përputhet dhe me informacionin e përftuar nga raporti i GVB.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse; Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.	Personeli akademik i institucionit publikon artikuj me përmbajtje shkencore të cilat janë në përputhje me disiplinat ku angazhohen. Artikujt janë të botuar në revista si dhe në konferenca të nivelit kombëtar dhe ndërkombëtar. Veprimtaria kërkimore e personelit akademik lidhet ngushtë me programin e studimit dhe me praktikën pra me industrinë dhe ndihmon në zhvillimin e sektorëve të veçantë të shkencës dhe të sektorëve të veçantë të shërbimeve.
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj; Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.	Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se një pjesë e personelit akademik të departamentit mund të angazhohet për të kryer studime në gjuhë të huaj pasi ka përvojë. Institucioni nuk ofron mësimdhënie në gjuhë të huaj, për programin MP në Sistemet e Energjisë.
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor; Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.	Gjatë vizitës në institucion GVJ verifikoj se AU ka organizuar konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjithashtu ka mbështetur pjesmarrjen në konferenca të ndryshme shkencore të stafit akademik dhe atij mësimor-shkencor. AU ofron lehtësira dhe hapësira për personelin akademik të interesuar në kualifikimin e mëtejshëm kjo është verifikuar pasi një nga pedagogët e Departamentit të Inxhinierive është larguar për kualifikimi të mëtejshëm. Kualifikimi i tij është mundësuar në kuadër të programit Erasmus+
Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.	
Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi; Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi; Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program	Gjatë vizitës në institucion GVJ verifikoj se institucioni ka në dispozicion bazën e të dhënave të publikimeve të antarëve. Në bazën e të dhënave ndodhet informacioni i plotë në lidhje me publikimet. Institucioni disponon bazë të dhënash për botimet e teksteve, librave, monografive, etj. Institucioni disponon bazën e të dhënave për projektet kërkimore shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare në të cilat është i angazhuar si dhe ka marrë pjesë.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Personeli akademik është i angazhuar në veprimtari kërkimore, ai mer pjesë në konferenca të cilat organizohen brenda dhe jashtë vendit. Veprimtaria e personelit akademik është e mbështetur nga institucioni si dhe e verifikuar në bazën e të dhënave që disponon vetë institucioni.
2. Programi i studimit MP në Sistemet e Energjisë është në proces akreditimi prandaj institucioni nuk mund të marrë pjesë në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me këtë program studimi. Institucioni ka punuar materialet didaktike në lidhje me programin mësimor të MP.

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun**Pjesa përshkrimore**

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Bashkëpunimi i AU si në planin kombëtar ashtu edhe në atë ndërkombëtar realizohet nëpërmjet nënshkrimit e zbatimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit. Në planin kombëtar këto marrëveshje janë nënshkruar me institucione dhe me subjekte private. Nga shqyrtimi i këtyre marrëveshjeve, GVJ konstatoi që, Departamenti i Inxhinierive bashkëpunon me 25 biznese. Ky bashkëpunim është në kuadër të praktikave mësimore.

Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi për shkëmbimin e stafit mësimdhënës me tre IAL të Republikës së Shqipërisë. Departamenti ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me disa kompani të huaja në kuadër të projekteve ndërkombëtare.

Marrëveshjet e nënshkruara nga AU me institucione të Arsimit të Lartë (UPT, Universiteti "A.Moisiu", Durrës, UET, Universitetin e Elbasanit, etj) janë në funksion të kontraktimit të personelit akademik të këtyre institucioneve, si dhe për bashkëpunim në fushën shkencore. Nga biseda me shefin e departamentit të inxhinierive GVJ mësoi që synimi i tyre është të angazhojnë personelin e kualifikuar këtyre institucioneve, pasi ata kanë përvojë dhe ndikim si në rritjen e cilësisë të mësimdhënies ashtu edhe në përmirësimin e kurrikulës dhe syllabuseve.

AU ka shtrirë bashkëpunimin edhe me subjekte apo institucione të huaja të cilat ofrojnë programe mësimore të ngjashme. Synohet që ky bashkëpunim të ndikojë në rritjen e mobilitetit për studentët e AU dhe në shkëmbimin e përvojave midis personelit akademik. Për personelin akademik në proces kualifikimi, do synohet dhe realizimi i kualifikimit të tyre nëpërmjet këtyre marrëveshjeve bashkëpunimi.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar
- Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare
 - Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj
 - Numri i pjesëmarrësve në trainime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit
 - Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL
 - Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor
 - Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime

IAL, Fakulteti i Shkencave të Aplikuar dhe Ekonomike si dhe Departamenti i Inxhinierive kanë marrë pjesë në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare. Aktivitetet janë zhvilluar në kuadër të bashkëpunimit midis IAL dhe

institucioneve përkatëse. Nga verifikimi i dokumentacionit të ofruar nga departmenti si dhe nga raporti i GVB, GVJ nuk evidentoj asnjë ndryshim. Nga verifikimi i dokumentacioni u vërtetua se:

- Institucioni ka marrë pjesë si partner në 5 projekte.
 - Ka zhvilluar 7 leksione të hapura me lektorë të huaj.
 - Dy pedagogë kanë marrë pjesë në trajnime jashtë vendit.
 - Është mundësuar lëvizja (mobiliteti) për 5 studentë.
 - Departamenti i Inxhinierive ka 10 të cilët janë në mbështetje të programit mësimor dhe atij kërkimor.
 - IAL nuk ka marrë pjesë në aktivitete shkencore dhe prezantime jashtë vendit.
- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë:

- Institucionet qeveritare bashkëpunuese
- Organizatat Profesionale
- Komuniteti i biznesit, tregu i punës

IAL, Fakulteti i Shkencave të Aplikuar dhe Ekonomike si dhe Departamenti i Inxhinierive kanë marrëveshje bashkëpunimi me një numër të madh institucionesh dhe biznese private. Nga verifikimi i dokumentacionit të ofruar nga departmenti si dhe nga raporti i GVB, GVJ nuk evidentoj asnjë ndryshim. Nga verifikimi i dokumentacioni u vërtetua se:

- Institucioni nuk ka marrëveshje bashkëpunimi me organizata qeveritare.
- Ka 4 marrëveshje bashkëpunimi me organizata profesionale dhe kjo në kuadër të projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Ka marrëveshje bashkëpunimi me 25 biznese dhe firma ndërkombëtare për mundësimin e praktikave profesionale.
- Ka marrëveshje bashkëpunimi me 7 universitete dhe kolegje. Qëllimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit është shkëmbimi i stafit akademik dhe partneriteti në projekte.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve "Master Profesional", institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve "Master i Shkencave" ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitim të njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi. Marrëveshjet e bashkëpunimi janë vërtetuar nëpërmjet dokumentacionit të ofruar nga institucioni dhe kontratave të lidhura midis tij dhe kompanive. Këto marrëveshje ndihmojnë në zhvillimin e praktikave profesionale.</p>
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.	

Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;

Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisve respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.

Nga mënyra e organizimit të praktikave mësimore, projekteve me natyrë kërkimor/shkencore rezulton se institucioni nxit bashkëpunimin e personelit dhe shkëmbimin e informacionit midis tyre.

Organizimi dhe ndarja e detyrave për secilin prej anëtarëve të stafit akademik bën të mundur garantimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit. Të drejtat dhe detyrat e secilit prej anëtarëve të departamentit janë parashikuar në kontratën e punës dhe rregulloren e funksionimit të brendshëm.

Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.

Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;

Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;

Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;

Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.

Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe jashtë vendit. Institucioni në strategjinë e tij afatgjatë ka të dokumentuar si objektiv vazhdimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit me institucionet homologe jashtë vendit.

AU ka marrëdhënie bashkëpunimi me sipërmarrjet private. Marrëveshjet e bashkëpunimit janë nënshkura në kuadër të zhvillimit të praktikave profesionale dhe përmirësimit të kurrikulave.

AU në kuadrin e përmirësimit të cilësë në mësimdhënie, përmirësimit të kurrikulave ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe të arsimit të lartë. Këto marrëveshje vërehen dhe nga aktivizimi i lektorëve të jashtëm për organizimin e seminareve të hapur.

Nga dokumentacioni i verifikuar rezulton se marrëveshjet kontraktuale janë të shoqëruara me raport vlerësimi me qëllim përmirësimin e bashkëpunimit dhe realizimit të qëllimeve.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se grupi i vlerësimit të jashtëm e gjen të përputhur praktikën e ndjekur nga AU për të garantuar bashkëpunimin e brendshëm dhe të jashtëm sipas kriterëve të standarteve të parashkruara.
2. AU e ka orientuar bashkëpunimin e tij në këto drejtime:
 - Bashkëpunim me Institucione të Arsimit të Lartë
 - Bashkëpunim me subjekte private, aktiviteti i të cilave përkon me programet e studimeve të kolegjit
 - Bashkëpunim me Univesitete të huaja në projekte ndërkombëtare.
3. Në të gjitha këto drejtime AU ka arritur të përfitojë rekrutimin e personelit të kualifikuar, hapsirë konkrete për realizimin e ngarkesës praktike të procesit mësimor, teknologjinë e nevojshme për kryerjen e punëve të laboratorit dhe praktikave etj.

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR IMPLEMENTIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Analiza përmbledhëse e RVJ sipas metodës SWOT (Strengths-pikat e forta, Weaknesses- pikat e dobëta, Opportunities-mundësitë, Threats-pengesat).

a. Pika të forta:

1. Programi i Studimit Master Profesional në Sistemet e Energjisë është hartuar në përputhje me qëllimin dhe misionin e AU dhe në ruajtje të vlerave kombëtare e kulturore.
2. AU ka ngritur një bazë me të dhëna statistikore për studentët, që ndjekin këtë program studimi, dhe bën përpjekje për ndjekjen e zhvillimit të tyre.
3. IAL AU ka ngritur një infrastrukturë të përshtatshme dhe të mirëpajisur me laboratore në mbështetje të programit të studimit.
4. Studimi i Tregut të Punës, i kryer me detaje, ndihmon në njohjen e nevojave të tregut të punës si dhe në përmirësime të mëtejshme që mund të bëhen për këtë program studimi.

b. Pika të dobëta:

1. Pjesmarrja e Departamentit të Inxhinierive që mbështet këtë program studimi në projekte kombëtare e ndërkombëtare është e ulët.

c. Mundësitë:

1. IAL AU bën përpjekje për rritjen e cilësisë së personelit akademik dhe mbështetjen e tyre në rrugën e kualifikimit të mëtejshëm përmes marrëveshjeve ndërkombëtare që ka për mobilitet të stafit akademikstitucional në aktivitete trajnimi e mësimdhënie me Universitete Evropiane në kuadrin e Erasmus+ Programme.
2. Personeli akademik për këtë program studimi në 75% të tij ka gradën "Doktor". Rreth 75% e ngarkesës mësimore mbulohet nga personel akademik efektiv. Këto fakte mund të konsiderohen një mundësi e mirë për zhvillimin e qëndrueshëm të këtij programi studimi.
3. IAL AU bën përpjekje për rritjen e numrit të titujve të teksteve mësimore e shkencore në bibliotekën e tij si dhe vë në dispozicion libraritë online për studentët dhe stafin akademik.
4. IAL AU bën përpjekje për rritjen e informacionit rreth këtij programi studimi me qëllim rritjen e cilësisë së studentëve që do të ndjekin atë.
5. Rritja e bashkëpunimit me institucionet homologe brenda e jashtë Shqipërisë nuk do shërbejë vetëm për rritjen cilësore të stafit akademik por edhe në partneritetin për projekte të ndryshme. Ky bashkëpunim do të ketë impakt të drejtpërdrejtë në rritjen cilësore të programit të studimit.
6. Numri i studentëve të këtij programi studimi në vitin e parë akademik të tij, është një mundësi e mirë për zhvillimin e qëndrueshëm të tij.

d. Pengesat:

1. Numri i titujve të librave në Bibliotekën e institucionit, dedikuar për këtë program studimi është ende i ulët.

e. Rekomandime:

1. Departamenti i Inxhinierive në AU duhet të bëjë përpjekje të rrisë cilësinë e studentëve në hyrje të këtij programi studimi, nëpërmjet ndërgjegjësimit të tyre për rëndësinë që ka ky profil inxhinieri në

tregun aktual të punës. Kësaj mund t'i vijë në ndihmë promovimi i shembujve të mire të punësimit në fushën e studimit, që duhet afishuar edhe në faqen zyrtare të AU.

2. Departamenti i Inxhinierive në AU duhet të bëjë përpjekje të rrisë pjesëmarrjen e tij në projekte kombëtare e ndërkombëtare, duke e parë si një tregues që nxit prurjet për këtë program studimi si dhe rritjen e cilësisë së studentëve.
3. Departamenti i Inxhinierive në AU duhet të bëjë përpjekje të rrisë aplikimet për mobilitet të studentëve të këtij programi studimi, me qëllim plotësimin e njohurive teorike të studentëve si dhe eksperiencave studimore e praktike në IAL të tjera brenda ose jashtë vendit.

SUMMARY ANALYSIS OF STUDY PROGRAM IMPLEMENTATION

EER Summary Analysis according to SWOT method (Strengths, Weaknesses, Opportunities, Threats).

a. Strengths:

1. The study program Professional Master in Systems of Energy is prepared in accordance with the goals and mission of Higher Education Institution and keep the national culture values.
2. The Higher Education Institution has full statistics for the students, which are following this study program and makes efforts to evaluate their development.
3. The Higher Education Institution has the infrastructure and proper equipped laboratories to support the study program.
4. The detailed "Labor market study" helps to understand the needs for further improvements of this study program.

b. Weaknesses:

1. The number of participation in national or international projects of Department of Engineering that support this study program continues to be low.

c. Opportunities:

1. AU is doing efforts to hire the qualified academic personel and are supporting the further qualification of hired academic staff through inter-Institutional Agreements for staff mobility for learning and teaching with Evropian Universities in Erasmus+ Programme frame.
2. The effectiv academic personel for this study program is 75% of total academic personel and the lecturers are with grade "Doctor". Around 75% of the teaching load is covered from effective academic personel. This may be considered a good oportunity for a stable developement for that study programme .
3. The Institution makes effort to increase the number of scientific books in library and to get the proper e-library for students and academic staff.
4. AU makes efforts to increase the information about this study program in order to have better quality of students that would like to follow it.
5. Increasing the collaboration between homologe Instituions inside and outside of Albania not only to hire their qualified academic staff but to be partner in different projects. This collaboration has direct impact in increasing quality of study program.



6. The number of students for this study program in the first academic year of its activity is a good opportunity for a stable development of this study program.

d. Threats:

1. The number of text books in Institution's library, dedicated for this study program is still low.

e. Recommendations:

1. AU Engineering Department should make efforts to increase the quality of students at the entrance of this study program, through their awareness of the importance of this engineering profile in the current job market. This can be achieved by promoting good employment examples in the field of this study program, which should be posted on the AU website.
2. AU Engineering Department should make efforts to increase its participation in national and international projects, seeing it as an indicator that fosters the flow of this study program and increases the quality of the students.
3. AU Engineering Department should make efforts to increase student mobility applications for this study program, with the aim of completing theoretical knowledge of students as well as practical experiences at other HEIs within or outside the country.

External Evaluation Group

1. Dr.Lindita Dhano
2. Dr.Thomaq Koblara

